ISSN 1857-6443

Aleanca për Shqiptarët

Në Qeveri pa ministër!

Fq.3

KËSHILLAT E SHKOLLAVE

Nxënësit shumë pak të organizuar

Fq.6

"Djaloshi i artë", dhe shpresa e mundjes

Besir Alili

Fq.12

www.koha.mk

Koha

Njeriu që po përmban Trumpin

Fq.18-19

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3253 · e hënë 25 dhjetor 2017 · 0°c | +6°c · 15 DEN

FORUM

Strategjia "përça dhe sundo" e Moskës

Strategjia e "përçarjes dhe sundimit" të Moskës përreth kufijve të saj, është aq shumë e përhapur, sa që do të duhej një raport i gjatë për të përshkruar të gjitha rastet dhe mënyrat. Megjithatë, Kremlini ka...

Fq.10

RAJON

Shënimi i vijës me Malin e Zi, në janar

Fq.16

GLOBI

Refugjatët e harruar të Lesbosit

Fq.17

DOSSIER

Kush ishte mafiozi që frymëzoi filmin "Kumbari"

Fq.20

EDHE NJË MANDAT DO TË KALOJË ME EMRA MONIST TË SHKOLLAVE

S'KA KUSH E HEQ PEJÇINOVIQIN E TETOVËS

Me gjasë, nxënësit shqiptarë të gjimnazit "Kiril Pejçinoviq", të tekstilit "Gjoce Stojçevski", të mjekësisë "Nikolla Shtejn", të bujqësisë "Mosha Pijade", edhe shumë vite do të presin ndryshimet e emrave të shkollave, që assesi nuk po ndodhin

Fq.9

Gjobat për alkool nga 200 deri në 500 euro

Shkup, 24 dhjetor - Konsumimi i alkoolit, sidomos gjatë festave të fundvitit, në shumë raste është treguar i kobshëm, posaçërisht për shoferët dhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacionin rrugor. Kur edhe zyrtarisht kemi hyrë në javën e fundit të vitit 2017, nga Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion (KRSK), përmes një kumtese, i kanë paralajmëruar qytetarët, me theks të veçantë vozitësit, për larësinë e gjobave nga konsumimi i alkoolit gjatë kohës kur ato vozisin. "Drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit paraqet arsyen më të shpeshtë se pse ndodhin aksidentet rrugore, me çka pasojat janë të rënda, disa herë edhe fatale. Vdekjet që pasojnë si rezultat i këtyre aksidenteve shoqërohen me shumë dhimbje, lot dhe lëndime të rënda trupore. Shoferët e dehur, përkundër faktit se e rrezikojnë...

Fq.5

LAJMI I FUNDIT

ÇELËSI PARTIAK NUK GUXON TË JETË IMPERATIV GJATË PUNËSIMIT

Duhet të tejkalohen mosmarrëveshjet partiake dhe nuk mund çelësi partiak të jetë imperativ në angazhimin e kuadrove, konsideron kryeministri Zoran Zaev.Ai në emisionin "Noqno studio" në televizionin Telma tha se tentojnë çdo kapacitet të mundshëm të kuadrit që e ka shteti ta shfrytëzojnë. "Nuk mund çelësi partiak të jetë imperativ në vendimmarrjen e cilit do angazhim të dhënë. Ka shumë njerëz të partisë të cilët i udhëheqin institucionet dhe ata kanë paragjykim ndaj bashkpartiakëve të tyre, por në çdo rast me bordet tona qendrore dhe ekzekutive tregojmë se duhet t'i ndryshojmë punët. Nuk mund vetëm një parti të zëvendësohet me tjetër. Ka 70 për qind të njerëzve të cilët nuk janë anëtarë të partive dhe nuk i interesojnë partitë dhe dhashtë Zoti ta përjetojmë momentin e vendeve perëndimore ku fija e parë është normativi, kriteri dhe parimi", tha Zaev. Në lidhje me reformat në gjyqësi, deklaratat e gjykatësit Lazar Nanev dhe përzgjedhjen e bashkëshortes së anëtarit të KSHZ-së Igor Milev për gjykatëse në Gjykatën e Apelit, Zaevi theksoi se nuk ka kurrfarë ndikimi nga partitë e koalicionit ndaj gjyqësisë dhe se reforma më e madhe në gjyqësi është nëse fillojmë të zëvendësohemi si njerëz. Sa i përket kontestit për emrin me Greqinë, Zaevi përsëriti se nuk ka propozim të ri, por se në fund të janarit është dakorduar takim i ri. "Është caktuar sesion i ri në fund të janarit dhe me siguri çdo muaj do të ketë sesione ku do të zgjidhet çështja për emrin. Jam i bindur se këtë duhet ta bëjmë më vonë deri në fund të gjysmës së parë të vitit 2018", tha Zaev, duke shtuar se është i bindur se së bashku me palën greke mund të gjejnë zgjidhje të pranueshme.

MUNDËSI E SHKËLQYER PËR ZGJIDHJEN E EMRIT NË VITIN 2018

Athina dhe Shkupi kanë mundësi të shkëlqyer ta zgjidhin çështjen për emrin në vitin 2018. Lidershipi dhe vullneti i mirë i qeverive të dy vendeve janë inkurajuese, tha Brajan Hojt Li, zëvendës ndihmës sekretar shtetëror i SHBA-së, në intervistë për agjencinë greke të lajmeve ANA - MPA. "Lidershipi dhe vullneti i mirë që paradokohe e kanë shprehur dy qeveritë për këtë çështje janë inkurajuese. Negociatat do të jenë të vështira dhe të dy palët duhet të bëjnë kompromise, por si duket bisedat fillestare me ndërmjetësim të të dërguarit të posaçëm të Kombeve të Bashkuara, Methju Nimic ishin konstruktive" - tha Ji. Ai e inkurajon edhe zërin pozitiv që e shikon te kryeministri Zoran Zaev në zbatimin e reformave dhe përmirësimin e marrëdhënieve me vendet fqinje. Ai vlerësoi edhe se zgjedhjet lokale kanë kaluar në atmosferë të respektimit të lirive themelore. Ji në intervistë tha "nuk ekzistojnë plane të tilla" lidhur me spekulimet se ai do të ishte ambasadori i ri amerikan në Shkup. "Shtëpia e bardhë është e vetmja kompetente për ato çështje dhe nuk ka kumtuar diçka të tillë" tha Hojt për ANA - MPA.

SHUMICA SHQIPTARE NË KUVEND

"Mos e izoloni Kosovën, mos e vëni interesin personal para atij të Republikës. Iniciativa për shfuqizimin e Ligjit për Gjykatën Speciale e ndërmarrë nga një grup deputetësh është dëmi më i madh që mund t'i shkaktohet Kosovës. Një hap i tillë rrezikon thellësisht përkrahjen e aleatëve të Kosovës dhe mund t'i kthejë gjithë përpjekjet e shqiptarëve për liri e pavarësi shumë hapa prapa. Kërkojmë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës ta vënë interesin e qytetarëve dhe të Republikës para atij të individëve dhe të mos e votojnë me asnjë kusht këtë ndryshim. Bravo LDK, bravo LVV! Mos harroni, ju e keni shumicën shqiptare në Kuvend", shkruan gazetari Adriatik Kelmendi në profilin e tij në FB.

ALZHEIMERI KOLEKTIV

"Shoqëritë shqiptare vuajnë nga Alzheimeri kolektiv dhe indiferenca adaptive ndaj së keqes. E harrojnë shpejt të keqen dhe madje asaj i përshtaten. Prandaj edhe elitat shtetërore: demokracinë e bastarduan- në populizëm; shumicën - në tirani votuese; sundimin e ligjit - në dhunim në emër të ligjit", shkruan profesor Blerim Reka në profilin e tij në Facebook.

PËRGJEGJËSI I VDEKJES SË FLORENCIT

"Vdekja tragjike e 23 vjecarit Florenc Beqiraj në burgjet franceze është një lajm i kobshëm për çdo shqiptar. Kur në mbarë Evropën të rinjtë bashkohen në vatrat familjare për festat e fundvitit, mijëra te rinj shqiptarë detyrohen të largohen ilegalisht nga familjet e tyre në kërkim të dëshpëruar të mundësive që vendi i vet nuk ua ofron. Shkaktari dhe përgjegjësi kryesor i kësaj gjendje heshti edhe sot për vdekjen e Florencit 23 vjeçar, siç hesht çdo ditë për largimin masiv të shqiptarëve. Si qindra mijëra bashkëqytetarë bashkohem me dhimbjen e familjareve dhe miqve të Florencit duke ju shprehur ngushëllimet dhe solidaritetin tim njerëzor dhe familjar. Zoti i dhëntë Florencit paqen e përjetshme, familjareve forcën e domosdoshme, dhe ne të gjithëve kurajon për tu përballur me të vërtetat e dhimbshme dhe për tu ngritur mbi të keqen!", shkruan kryetari i Partisë Demokratike në Shqipëri, Lulzim Basha.

KUNDËR APO JO AMERIKËS

"Kundër Amerikës, edhe kur gjykojmë se nuk e ka drejtë në punët tona, NE duhet ta pranojmë qëndrimin e saj "të gabuar në sytë tonë". Arsyeja e vetme, e një pranimi të këtillë të pahamendësuar e publik, kujtoj që qëndron ende te ajo vogëlsia e jonë (demografike; ekonomike; e ushtarake) famëkeqe historike në rajon. Nëse, ajo ndonjëherë "lodhet" (e gjasat janë të vogla, jo sa shkaku ynë sa shkaku i interesit të Asaj vetë, në Ballkan) nga kjo status quo-ja e jonë e ripërsëritur historike, pra, nëse arrin të bëhet aq monotone me vogëlsinë tonë meskine, ajo në "ndërkohën" e mosrefuzimi" tonë, duhet të paktën të punojë në fuqizimin dhe faktorizimin tonë sistematik, këndejpari. Pra, si komb kemi shumë nevojë të na konsolidojë; EKONOMIKISHT (përmes ekspertizave speciale dhe përvojës për mënyrat e reduktimit të; gangrenës së krimit dhe korrupsionit)", shkruan sociologu nga Prishtina, Fadil Maloku.

MEDIACitate

Nisma që nxiti krizën e brendshme politike të Vetëvendosjes është tanimë zyrtare, e pohuar përmes një postimi në Facebook të anëtarit të Këshillit të Përgjithshëm të kësaj parti, Erzen Vraniqi: Albin Kurti do të kandidojë për drejtimin e lëvizjes së themeluar prej tij, e cila doli si forca e vetme më e madhe nga zgjedhjet lokale. Vraniqi pohon në mesazh se e ka vënë firmën e vet në mbështetje të kësaj kandidature. "Komisioni i Përgjithshëm zgjedhor e miratoi pas verifikimeve deklaratën e kandidimit, e grumbullimi i nënshkrimeve ka nisur zyrtarisht", shkruan ai. Vetëvendosja është në ethet e përgatitjeve për zgjedhjen e drejtuesit të saj të ri, që duhet të ndodhë në muajin shkurt.

(Top Channel, 24 dhjetor)

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj thotë se vota e Kosovës në OKB do të ishte në një linjë me SHBA-të sa i takon çështjes së Jerusalemit. "Nëse më dëgjon ambasadori i Kosovës, në politikë të jashtme ne e përcjellim Amerikën", tha Haradinaj për televizionin publik. Kryeministri Haradinaj tha se "nuk e komentoj vendimin e shtetit shqiptar", derisa evokoi kujtime nga lufta e fundit kur shteti dhe lobi izraelit kishin ndihmuar çlirimin e Kosovës. Këtë muaj, Presidenti amerikan Donald Trump njohu Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit. Por Shqipëria u bashkua me 128 vendet që e kundërshtuan vendimin e shefit të Shtëpisë së Bardhë.

(Express, 24 dhjetor)

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, është shprehur se organizata e ulët terroriste FETO ka "mashtruar popullin nëpërmjet retorikave të dialogut, arsimit dhe veprave të mira", duke shtuar se "Jemi të vendosur që kjo kope vrasësish të mos jetë e pranishme në Afrikë". "Shumë vende të Afrikës pas tentativës për grusht shteti kanë deportuar anëtarët e FETO-s por edhe kanë dorëzuar shkollat e tyre tek fondacioni ynë Maarif. Vërejmë se kjo po rritet çdo ditë e më shumë. Kam besimin e plotë se do të rritet edhe më shumë. Jemi të vendosur që kjo kope vrasësish të mos jetë e pranishme në Afrikë", është shprehur presidenti Erdogan.

(Anadolu Agency, 24 dhjetor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

Ç'ËSHTË "ODA E MIQVE"?

Oda e miqve është mjedisi më paraqitës në banesën tradicionale shqiptare, vendi ku priteshin miqtë sidomos në rastet e ngjarjeve e të ceremonive familjare. Zë vendin më të mirë në kompozimin e banesës dhe dallohet nga pajisjet e trajtimi i pasur dekorativ.

Vend qendror ka oxhaku në banesën fshatare, i cili shpesh është vetëm dekorativ në atë qytetare. Tipare të veçanta të odës së miqve janë gdhendjet në dru në pjesë si tavanë, dollapët e murit, musandrat, dyert etj., zbukurimi i oxhakut, dhe në disa raste pikturimi i mureve. Janë të përmendura për zbukurimet në dru veçanërisht banesat në Shkodër, Berat, Gjirokastër, Prizren, Gjakovë dhe Elbasan. Me futjen e mobiljeve oda e miqve thjeshtohet dhe dora-dorës zhvishet nga punimet dekorative.

AMBASADORI GARET PËR REL

Në një kodër të lartë për negociata me BE-në

Shkup, 24 dhjetor - Vijon një detyrë e vështirë për vitin e ardhshëm që Maqedonia të marrë datë për fillim të negociatave me BE-në, thotë ambasadori i Britanisë së Madhe në Maqedoni, Çarls Garet. Në intervistën javore për Radio Evropa e Lirë, ai tha se duhet të zbatohen reformat nga Plani 3-6-9, të dilet nga shteti i "robëruar", të adresohet çështja e emrit. "Për gjetjen e një zgjidhje të pranueshme për emrin do të jenë të nevojshme vendime të rënda dhe guxim i vërtetë politik. Janë ndërmarrë hapa të dobishëm, hapa konkret, por bëhet fjalë për një rrugë të gjatë për çlirimin e shtetit, duke rikujtuar: kjo është maratonë, jo vrap i shkurtë", tha Garet. Ai gjithashtu foli edhe për atë se cilat janë reformat kyçe të cilave duhet t'ju jepet përparësi duke thënë se pikat e reformave janë shumë qartë të vendosura në Planin 3-6-9. "Jemi shumë të lumtur që Ambasada britanike mund në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndihmojë në zbatimin e tyre. Janë të përfshira fusha si administrata publike, sistemi i kundërzbulimit, temë për të cilën u bisedua edhe gjatë vizitës së ministres për mbrojtje, Radmilla Shekerinska në Londër dhe shqyrtimi i mbrojtjes strategjike, por është shumë e vështirë të përkufizohen në mënyrë konkrete", tha Garet. Në pyetjen nëse është i arsyeshëm optimizmi i kryeministri Zoran Zaev, i cili pret që Maqedonia të marrë datë për negociata parainkuadruese me BE-në deri në qershor të vitit 2018, Garet u përgjigj pozitivisht. "Po, absolutisht. Mendoj se keni një kodër shumë të lartë në të cilën duhet të ngjiteni për të arritur atje deri në mesin e vitit të ardhshëm. Ka shumë për tu bërë në Planin 3-6-9, si dhe në "shtetin e robëruar" dhe detyrimisht duhet të zgjidhet çështja e emrit. Pra, ekziston detyrë e vështirë, por është plotësisht e arsyeshme të jetë optimist. Për mundësinë e rrezikut nga një krizë e re politike në Maqedoni në rast se bojkoti i Kuvendit nga ana e opozitës vazhdon edhe më tutje, ambasadori britanik tha se mendon që Maqedoni ka mbyllur një kapitull të krizave politike, që është një hap i mirë para. Por, tha ai, mbeten shumë shkaqe të nënvizuara për krizë mbeten dhe gjendja ende është e brishtë dhe rreziku mbetet", tha Garet në intervistën për REL.

KUVENDI I ALEANCËS PËR SHQIPTARËT

NË QEVERI PA MINISTËR!

"Kryeministri edhe vetë e ka deklaruar se nuk bëhet fjalë për rekonstruim të Qeverisë, por vetëm për plotësim të vendeve boshe siç është ai për Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë i ka takuar ASH-së dhe për këtë ne nuk kemi pse të diskutojmë", tha Ziadin Sela gjatë një konferencës për gazetarë menjëherë pas mbarimit të punës së Kuvendit të partisë

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 24 dhjetor - Aleanca për Shqiptarët vendosi të pres si do të veprojë LSDM dhe BDI për Ministrinë e Shëndetësisë që më pas të marrë vendim nëse do të dalë nga Qeveria. Siç pritej të dielën në mbledhjen e Kuvendit Qendror, ASH nuk vendosi për të braktisur Qeverinë. "Kemi premtuar që të zgjidhet me Ligj çështja e gjuhës shqipe dhe ajo është shumë afër të zgjidhet, kemi premtuar të nisë zgjidhja e proceseve të montuara dhe ajo ka nisur. Për këtë çështje nuk është dashur të diskutojmë. Kryeministri edhe vetë e ka deklaruar se nuk bëhet fjalë për rekonstruim të Qeverisë, por vetëm për plotësim të vendeve boshe siç është ai për Shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë i ka takuar ASH-së dhe për këtë ne nuk kemi pse të diskutojmë", tha Ziadin Sela gjatë një konferencës për gazetarë menjëherë pas mbarimit të punës së Kuvendit të partisë. Në pyetjen se çfarë do të bëjë ASH kur sot (e hënë) LSDM do të propozojë kandidatin e tyre për ministër të Shëndetësisë, Venko Filipce, Sela tha se "do të shohin kur do të votohet në Parlament". "Qëndrimet tona janë parimore dhe principele. Do të informoheni në të ardhmen në lidhje më këtë vendim nëse do të ketë një vendim të tillë", tha ai. Ndryshe, ashtu siç ka paralajmëruar ditë më parë kryeministri Zoran Zaev, sot më 25 dhjetor ka gjasa të votohen në Parlament emrat e propozuar për ministër të Shëndetësisë, ministër pa resor nga partia e romëve, zëvendësministri i Arsimit dhe zëvendësministri i Bujqësisë. Siç dihet, për ministër të Shëndetësisë është propozuar Venko Filipçe me profesion neurokirurg dhe që aktualisht është këshilltar për shëndetësi i kryeministrit Zaev, për zëvendësministër të Arsimit është propozuar Arbër Ademi nga BDI, profesor universitar në UT, i cili më parë ka ushtruar postin e zëvendëskryeministrit për çështje evropiane në Qeverinë teknike të ish-kryeministrit Emil Dimitriev nga VMRO. Për ministër pa resor nga partia e romëve, në vend të Samka Ibrahimovski është propozuar avokati i njohur Amsel Ahmedovski. Ndërkaq për ministër pa resor që mbulon Investimet e huaja, nga BDI nuk kanë vendosur, por sipas burimeve anonime të afërta me partinë e Ahmetit, për këtë resor do të pritet ende deri në një kohë afatshkurtër. Në këtë drejtim, ka zëra se gjatë janarit të vitit të ardhshëm nëse del ASH, mund të përfshihet PDSH në Qeveri dhe ministri pa resor për Investime të huaja dhe postet e zëvendësministrave nga ASH mund ti takojnë PDSH-së. Në PDSH, funksionarë të lartë të saj nuk pranojnë të flasin nëse do të jenë apo jo pjesë e Qeverisë. Megjithatë, pas daljes eventuale të ASH nga Qeveria, është e pritshme që pas mbështetjes publike që BDI-së i ka dhënë PDSH në zgjedhjet e fundit, partia e Menduh Thaçit të participojë në Qeveri, ndërsa do të votojë emrat e propozuar nga kryeministri Zaev së fundmi. Zaevi gjatë një intervistë për TV TELMA, në lidhje me PDSH-në përsëriti se dera është e hapur për çdo parti. "Deri në këtë moment nuk jemi në bisedime me PDSH-në që ajo të hyjë në Qeveri. Përbërja e Qeverisë ngelet ashtu si ka qenë", ka deklaruar Zaevi. Edhe në rast të mospjesëmarrjes në votim të dy deputetëve të PDSH-së, Menduh Thaçi dhe Merale Yzeri Ferati, me shumë gjasa deputeti rom Amdi Bajram dhe Çedomir Sazdov që më parë ishte në koalicion me VMRO-në, do të votojnë "pro" propozimeve të Zaevit. Kjo, pasi LSDM me 49 deputetë dhe BDI me 10 kanë nevojë për dy vota që të kompletohet Qeveria. Ndryshe, Aleanca për Shqiptarët të dielën ka mbajtur mbledhje të Kuvendit Qendror në Gostivar për të vendosur nëse do vazhdojë të jetë pjesë e Qeverisë pa ministrinë e Shëndetësisë, por me atë të zëvendëskryeministrit për Reforma i ofruar nga kryeministri Zoran Zaev. Përveç kësaj, ASH ka vendosur edhe për zgjedhje të brendshme partiake më 11 mars të 2018-ës, kur dhe do të mbahet Kongresi zgjedhor si organ më i lartë partiak, ndërsa siç mësohet, kryetar i Këshillit për organizimin e Kongresit është zgjedhur sekretari i përgjithshëm i ASH-së, Arben Taravari.

Por deri në mbylljen e gazetës pasdite nuk pati qëndrim përfundimtar. ASH kishte propozuar emrin e mjekut të njohur Vullnet Ferati nga Dega e Tetovës për ministër të Shëndetësisë, por që u refuzua nga kryeministri Zaev të enjten e kaluar pas takimit që pati me kryetarin e ASH-së, Ziadin Sela. Nga LSDM mbajnë qëndrimin se posti i ministrit të Shëndetësisë i është ofruar ASH-së për shkak të Arben Taravarit ndërkaq për emra tjerë nuk janë të sigurt se mund të bëjë reformat e kërkuar në sektorin e Shëndetësisë. Por, këto qëndrime të LSDM nuk janë marrë seriozisht nga ASH. Ishte vetë Arbën Taravari, përveç kryetarit Sela dhe eksponentë tjerë të lartë të kësaj partie, që gjatë një postimi në profilin e tij në Facebook, i quajti qesharake pretendimet e kryeministrit duke thënë se Shëndetësia i është dhënë ASH-së, jo për shkak të emrit të tij, por për shkak të ngjarjeve të 27 prillit. "Sigurisht që Ministria e Shëndetësisë iu dha Aleancës se pa këtë parti nuk bëhej dot Qeveria! Qeveria! E mbani mend si nisi ky ndryshim?! Ishte ajo kohë kur në Parlament, ju u gjakosët, por ama Ziadin Sela krah jush desh vdiq! Ju kujtoj, jo Ali Ahmeti që keni në krah, po Ziadin Sela! Dhe pa asnjë dyshim unë u zgjodha nga Aleanca dhe jo nga ju për ta drejtuar atë ministri! Pa asnjë dyshim ju nuk keni asnjë argument serioz bindës për t'i treguar popullit dhe bini në nivele infantile! Kush ju bëri të humbisni fillin z.Zaev?!", shkruan Arben Taravari kundër kryeministrit Zaev.

MES DEMOKRATIZIMIT DHE VAZHDIMIT TË POLITIKAVE NACIONALISTE

GRUEVSKI, KRYETARI NË HIJE I VMRO-së

Ish-anëtarë të lartë të VMRO-së, deputetë, ish-ministra dhe zyrtarë të tjerë thonë se VMRO-në edhe pas këtij Kongresi, do të udhëheqë hija e Gruevskit dhe se partia do të përjetojë përçarje të mëdha

Shkup, 24 dhjetor - VMRO-DPMNE, partia më e madhe opozitare në Maqedoni, po përballet me sfidat më të mëdha që nga pluralizmi, e që kanë të bëjnë me demokratizimin-ndryshimin e kursit të veprimit apo vazhdimin politikës së deritashme. Kjo parti konservatore që nga viti 2003 udhëhiqej nga Nikolla Gruevski, i cili për një dekadë ka qenë edhe kryeministër i vendit, apo deri në qershor të këtij viti kur u zëvendësua nga social-demokrati, Zoran Zaev. Gruevski dha dorëheqje pas humbjes së thellë që pësoi partia e tij në zgjedhjet lokale, por edhe pas burgosjes së shumë bashkëpunëtorëve të tij të dyshuar për dhunën në Kuvendin e Maqedonisë, më 27 prill të këtij viti. Hristijan Mickovski është figura kyçe e partisë, i cili si sekretar i përgjithshëm i VMRO DPMNE-së, në Kongresin e jashtëzakonshëm në Vallandovë, u zgjodh kryetar i VMRO-së

Por, Kongresi është kritikuar nga shumë figura qendrore të partisë, duke akuzuar për procedura jodemokratike, mbajtjen e tij në procedurë të shpejtuar dhe me imponime nga Nikolla Gruevski për të zgjedhur, siç thonë, njeriun e besuar të tij. Për shkak të kësaj, përveç Mickovskit, askush nuk kishte pranuar të kandidojë për kreun e partisë. Ish-anëtarë të lartë të VMRO-së, deputetë, ish-ministra dhe zyrtarë të tjerë thonë se VMRO-në edhe pas këtij Kongresi, do të udhëheqë hija e Gruevskit dhe se partia do të përjetojë përçarje të mëdha. "Nga kjo që ndodhi, nga VMRO-DMPNE nuk do të ketë as V e as D. Pas Nikolla Gruevskit, do të kemi Hristijan Gruevski. Ky është fillimi i fundit të DPMNE-së pasi zhvillimet që do të pasojnë, do të jenë përçarëse për partinë. Do të ketë grupe pa komandë dhe secili do të punojë sipas interesave personale".

"Kryetari i ri nuk do të ketë asnjë rol, përveç atij për mbrojtjes e udhëheqësisë kriminale që ka drejtuar partinë deri tani. Grupimet që janë kundër zhvillimeve të tanishme në VMRO, nuk do të rrinë duarkryq, por do të ndërmarrin masa për organizimin e një kongresi të ri", thotë Jove Kekenovski, një nga ish-themeluesit e VMRO DPMNE-së. Ngjashëm vlerëson edhe Ilir Luma, njohës i çështjeve politike dhe ish-zyrtar i lartë i Partisë së Prosperitetit Demokratik, partisë së parë demokratike të shqiptarëve në Maqedoni. Ai thotë se me Hristijan Mickovskin, i afërt me ish-kreun e partisë, Gruevskit, VMRO-ja do të vazhdojë me pengimin e proceseve reformuese në vend. "VMRO-ja ende nuk është çliruar nga diktati brendapartiak, i trashëguar nga ish-lideri i saj partiak, Nikolla Gruevski. Në planin ndërkombëtar edhe më tej do të vijë në shprehje qëndrimi i ngurtë i kësaj partie karshi çështjes së emrit që ka Maqedonia me Greqinë. Pra, ajo gjithnjë do të bëjë përpjekje që të bëjë pengesa që të mos ketë ndonjë zgjidhje adekuate që e mban peng vendin për të ecur në rrugën e integrimit euroatlantik", vlerëson Luma. VMRO-ja njihet në opinion edhe me politikat e saj nacionaliste. Kjo parti në vazhdimësi ka kundërshtuar kërkesat e shqiptarëve për avancimin e statusit juridik në shtet. Madje, shumë herë ka organizuar edhe protesta e aksione të ndryshme. Kjo parti fajësohet edhe për zhvillimet në Kumanovë, dy vite më parë që lanë më shumë se 20 të vrarë, rastet "Monstra", "Sopoti", dhunën në Kuvend raste tjera. Jove Kekenovski nuk beson se kjo parti mund të ndryshojë kursin e veprimit sa i përket raporteve ndëretnike.

"VMRO-ja nuk mund të demokratizohet me njerëz të tillë, e aq më pak të reformohet. Ai ndoshta vetë mund të ndryshojë qëndrimin ndaj shqiptarëve, por nuk do të ketë autoritet që ta imponoj tek anëtarësia e gjerë", thotë Kekenovsi, ish-themelues i VMRO-së. Edhe Luma mendon se për ndryshimin e veprimit në raport me shqiptarët në VMRO, duhet të ndodhin ndryshime të mëdha. "Vlerësoj se nuk mjaftojnë vetëm se deklaratat që jepen nga disa bartës të funksioneve në VMRO, sepse kjo parti nuk do të ketë guximin që të zhvishet nga koncepti i saj nacionalist. Unë jam skeptik se mund të ndodhë diçka në relacionin e VMRO-së me shqiptarët, të cilët kanë probleme të mëdha brenda Maqedonisë e që duhen të zgjidhen. Pra, vlerësoj se VMRO-ja do të vazhdojë të bëjë obstruksione karshi kërkesave të shqiptarëve për një avancim të statusit të tyre juridiko-kushtetues", thotë Luma. *(REL)*

TI JEPET SHANS MICKOVSKIT

Kryetar i parë i VMRO-DPMNE-së, Lubço Georgievski, i ka dhënë përkrahje përzgjedhjes së Hristian Mickoskit për lider të ri të VMRP-DPMNE-së, duke vlerësuar se ai është kandidati më adekuat nga gjithë ata që janë ofruar për tu kandiduar. "Hristian Mickoski nga të gjitha emrat që ishin kandidat për kryetar të VMRO-DPMNE-së, megjithatë është më pak i korruptuari, nuk ka afera, më energjik dhe më karizmatik. Hristian ka shansin të vendos vulën e tij në VMRO. Duhet ti jepet shansi", shkruan Gjeorgievski.

KEMI NEVOJË PËR PAJTIM, TOLERANCË DHE MIRËKUPTIM

Hristian Mickoski një ditë pasi u zgjodh për kryetar të VMRO-DPMNE-së ka vizituar Kishën e Shën Maria në Strumicë, prej ku ka apeluar që vendit I duhet pajtim, tolerancë dhe mirëkuptim për të gjithë. "Si popull këtij shtetit i duhet pajtim, tolerancë dhe mirëkuptim për gjithë të tjerët. Unë sot kamë vendosur të filloj mandatin si kryetar i VMRO-së nga ky vend dhe të lutem për qetësi për gjithë qytetarët e Maqedonisë", ka thënë Hristian Mickoski

KRONIKË

Varroset vëllai i dëshmorit që vdiq aksidentalisht

Kumanovë, 24 dhjetor - Është varrosur të dielën pasdite Ejup Kasumi, 41-vjeçar nga fshati Sllupçan i Komunës së Likovës, i cili të shtunën ndërruar jetë aksidentalisht në malin e fshatit Izvor. 41-vjeçari, sipas raportit të policisë, si dhe dëshmitarëve në vendngjarje, kishte mbetur i vrarë pasi një plumb i pushkës së tij të gjuetisë e ka goditur në anën e djathtë të gjoksit. "Të dhënat e para dhe pozita e armës dhe e trupit tregojnë se tashmë i ndjeri është vetëplagosur. Me gjasë ka rrëshqitur pas tentimit për t'i ndarë zagarët që kishin filluar të kacafyteshin", thonë policët që bënë hetimin në vendngjarje. Pushka e gjuetisë së të ndjerit ishte e thyer, me çka dëshmohet se bëhet fjalë për tragjedi. Ejupi është vëllai i dëshmorit të UÇK-së, Harun Kasumi, ndërsa pas vetes ka lënë dy fëmijë të mitur: Harun dhe Shaqir Kasumin.

Një i vdekur dhe një tjetër po lufton për jetë

Shkup, 24 dhjetor - Një shkupjan (23) e ka humbur jetën, ndërsa moshatari i tij nga Ohri është në rrezik për jetë pas aksidentit që ka ndodhur mbrëmë në orën 03:13 në afërsi të shkollës fillore "Koço Racin" në Shkup. Siç është theksuar në raportin e policisë, në aksidentin në bulevardin "Nënë Tereza" shkupjani D.S: (23) duke e drejtuar automjetin "BMV" me targa të Shkupit është përplasur në një shtyllë. Shoferi, si dhe bashkudhëtari A.N. (23) nga Ohri, janë lënduar më lehtë dhe janë dërguar në Qendrën emergjente-Shkup, ku rreth orës 3:50 D.S. ka ndërruar jetë, ndërsa A.N. është në rrezik për jetë.

SHOFERËT TË MËNJANOJNË KONSUMIMIN E ALKOOLIT

GJOBAT PËR ALKOOL NGA 200 DERI NË 500 EURO

Fakti se shumica e qytetarëve në këtë kohë festojnë, marrin pjesë nëpër ahengje të ndryshme, mes të cilave edhe ato që organizohen pas orarit të punës, ndryshe siç njihen "After Work Ahengje", sipas KRSK-së, nuk nënkupton se shoferëve ju lejohet konsumimi i alkoolit, gjegjësisht drejtimi i veturave në këtë gjendje do të sanksionohet

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 24 dhjetor - Konsumimi i alkoolit, sidomos gjatë festave të fundvitit, në shumë raste është treguar i kobshëm, posaçërisht për shoferët dhe pjesëmarrësit tjerë në komunikacionin rrugor. Kur edhe zyrtarisht kemi hyrë në javën e fundit të vitit 2017, nga Këshilli Republikan për Siguri në Komunikacion (KRSK), përmes një kumtese, i kanë paralajmëruar qytetarët, me theks të veçantë vozitësit, për lartësinë e gjobave nga konsumimi i alkoolit gjatë kohës kur ato vozisin.

"Drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit paraqet arsyen më të shpeshtë se pse ndodhin aksidentet rrugore, me çka pasojat janë të rënda, disa herë edhe fatale. Vdekjet që pasojnë si rezultat i këtyre aksidenteve shoqërohen me shumë dhimbje, lot dhe lëndime të rënda trupore. Shoferët e dehur, përkundër faktit se e rrezikojnë jetën e tyre dhe personave tjerë në automjetin që e drejtojnë, ata shpeshherë janë rrezik potencial edhe për jetën e pjesëmarrësve tjerë në komunikacion", thonë nga KRSK-ja.

Fakti se shumica e qytetarëve në këtë kohë festojnë, marrin pjesë nëpër ahengje të ndryshme, mes të cilave edhe ato që organizohen pas orarit të punës, ndryshe siç njihen "After Work Ahengje", sipas KRSK-së, nuk nënkupton se shoferëve ju lejohet konsumimi i alkoolit, gjegjësisht drejtimi i veturave në këtë gjendje do të sanksionohet. Njëkohësisht, nga ky Këshill, në paralajmërimin e tyre theksojnë se vozitësit janë ajo kategori, e cila në këtë periudhë duhet të dëshmojë pjekurinë dhe ndërgjegjen më të madhe. Duke i numëruar ndikimet negative që alkooli i shkakton te një shofer, nga KRSK kanë thënë se vozitësve që konsumojnë alkool në masë të madhe ju zvogëlohen aftësitë e menaxhimit të automjetit në komunikacion, gjegjësisht efektet negative në radhë të parë vijnë gjatë kohës kur ata duhet të reagojnë shpejtë dhe në kohë. "Alkooli ndikon në sistemin qendror nervor dhe e zvogëlon aftësinë e gjykimit racional dhe aftësitë e parashikimit të rreziqeve dhe kërcënimeve në komunikacion. Personat në ndikim të alkoolit, posaçërisht rinia, ka prirje më të madhe për ndërmarrjen e rrezikut dhe sjelljeve agresive në komunikacion. Rezultat i këtyre veprimeve, shpesh herë rezultat me pasoja fatale", thonë nga KRSK-ja. Korniza ligjore e cila i parasheh gjobat për këtë kategori të vozitësve, thotë se shoferët të cilët kanë konsumuar më tepër se 0.50 miligram alkool, nuk guxojnë t'a ndezin automjetin, aq më pak të kyçen në komunikacion. Për shoferet fillestar, siç theksojnë normat ligjore, konsumimi i alkoolit është i lejuar deri në shkallën 0,09 miligram, gjegjësisht thënë me fjalë tjetër toleranca ndaj këtyre vozitësve për çështjen e alkoolit është "zero". Megjithatë, nëse një shofer i tillë ndalohet nga policia rrugore dhe konstatohet se në gjakun e tij ekziston një sasi prej 0.50 miligram alkool, atëherë ndaj tij do të shkruhet një gjobë prej 200 euro (në kundërvlerë denarë), patentë shoferi do t'i regjistrohet me 40 pikë negative dhe për tre muajt e ardhshëm do të ketë ndalesë të kyçen në komunikacion.

"Ndryshe, drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit, në sasi prej 51-1.00 miligram, sanksionohet me 225 euro, minus 40 pikë negative në patentë shofer dhe prej tre deri në gjashtë muaj mundet t'i shqiptohet ndalesa për kyçje në komunikacion. Gjoba prej 275 euro do t'i shqiptohet atij shoferi që në gjakun e tij konstatohet prezenca e 1.01-1.50 miligram alkool, respektivisht në patentë shofer do t'i shënohen 50 pikë negative dhe nga gjashtë deri në nëntën muaj do t'i konfiskohet leja për vozitje. Tutje, gjoba prej 325 euro, sipas Ligji për siguri në komunikacion, 55 pikë negative dhe konfiskimin e patentë shoferi deri në një vit, është paraparë t'i shkruhet shoferit i cili në gjakun e tij ka 1.51-2.00 miligram alkool", paralajmërojnë nga KRSK-ja. Ndryshe, gjoba prej 500 euro, mund t'i shqiptohet atij shoferi, i cili do ta refuzojë nënshtrimin ndaj alko-testit, respektivisht me këtë veprim ai rrezikon 65 pikë negative në patentë shofer dhe një ndalesë për prezencë në komunikacion prej 12 muaj. Gjatë këtij viti, sipas raportit të fundit të këtij institucion shtetëror, nëpër akset rrugore të Maqedonisë kanë ndërruar jetë 122 persona, me çka janë regjistruar mbi 7 mijë aksidente rrugore.

Asnjë eveniment për 49-vjetorin e demonstratave

Tetovë, 24 dhjetor -Tashmë kur mbushen 49 vjet nga demonstratat e vitit 1968 në Tetovë, pothuajse asnjë institucion lokal apo qendror nuk e ka parë të udhës që të organizojnë një përkujtim për nderë të këtyre demonstratave. Ka qenë një nga protagonistët e kësaj ngjarje Fadil Lushi që ka përkujtuar 23 dhjetorin e vitit 1968, duke theksuar se organizatorë të atyre protestave për flamurin kombëtar kanë qenë tashmë të ndjerët Faik Mustafa dhe Memetriza Gega. Sipas Lushit, në ato demonstrata kanë marrë pjesë edhe nxënës të Gjimnazit të Tetovës në krye me Rafi Halilin, kurse ende ky gjimnaz, siç thotë Lushi, mban emër johuman për qytetarët e Tetovës. Pas demonstratave, gjykatat në Maqedoni dënuan dhjetëra intelektualë dhe të rinj, me akuzën për propagandë armiqësore dhe prishje të rendit. Mes të akuzuarve u gjetën intelektualët tetovar Harun Jakupi, Salahudin Hyseini, Mahmut Bajraktari, Abdulla Kalishta, Mehmetriza Gega, Faik Mustafa, Fadil Lushi, Sali Saliu, Rafi Halili dhe shumë aktivistë të të tjerë. *(U.H)*

KRONIKË

Rrahen nxënësit e shkollës "Pançe Karagjozov"

Katër nxënës të vitit të tretë të shkollës së mesme të mjekësisë "Pançe Karagjozov" në Shkup, fizikisht kanë sulmuar dy moshatarë të tyre, nxënës në të njëjtën shkollë. Rastin në polici e ka paraqitur një i punësuar në shkollë dje në mëngjes rreth orës 10:00. Merren masa për zbardhjen e rastit.

Njëzetë e pesë të arrestuar për shitje të drogës

Njëzetë e pesë persona janë arrestuar nën dyshimin se merren me shitje në rrugë të drogës. Gjatë bastisjeve dje në mëngjes nga ana e policisë janë gjetur 49 paketime heroinë, rreth 1,8 kilogram marijuanë, tableta ekstaza, një paketim amfetaminë dhe një grumbull hashash. Janë gjetur disa pushka të ndryshme, një pistoletë me gaz dhe 28 plumba. Janë marrë edhe një kompjuter dhe 324 blanko kartela. Policia kumtoi se pas dokumentimit të rasteve do të parashtrohen kallëzime penale për veprat e bëra penale "prodhimtari e paautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike dhe substancave psikotrope", "prodhimtari e palejuar, mbajtje dhe tregtim me armë dhe materie spërkatëse", "parandalim i personit zyrtar gjatë kryerjes së veprimeve zyrtare", si dhe kallëzime adekuate penale nga sfera e krimit kompjuterik, delikte pronësore etj.

Dy motra ikin nga shtëpia

Në policinë e Tetovës, nga ana e Xh.S 61-vjeçare nga fshati Sellcë është denoncuar se para dy muajve, është larguar nga shtëpia vajza e saj G.E 24-vjeçare nga Senakosi, e cila me vete e ka patur edhe motrën e saj 16-vjeçare. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Kosovari kapet me veturë të falsifikuar

Në vendkalimin kufitar Jazhincë, gjatë vikendit në hyrje për në Maqedoni është paraqitur H.H 38-vjeçar nga Kosova që e ka drejtuar makinën Opel Vektra. Nga kontrolli i kryer është konstatuar se vetura është e falsifikuar dhe Numri VIN nuk korrespondon me numrin në lejen e qarkullimit. Nga ana e policisë është marrë me vërtetim vetura.

4 padi penale për organizim të lojërave të fatit

Departamenti për ndaljen e krimit të organizuar pranë MPB-së ngriti katër padi penale deri te Prokuroria Themelore Publike Tetovë dhe Prokuroria Themelore Publike në Gostivar, kundër personave A.H. (55) nga Tetova dhe D.M (32) nga fshati Kamjan i Tetovës, A.Ç. (49) nga Gostivari dhe A.L (48) nga Tetova për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer vepër penale "organizim të lojërave të fatit pa licencë, gjegjësisht leje nga organi përkatës" sipas nenit 156, pikës 3 të Ligjit për lojërat e fatit. Pas planit të përgatitur operativ, nëpunës të MPB-së dhe ekipe të DAP-it kanë kryer bastisje në më shumë bastore sportive në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit, ku DAP ka konstatuar se të denoncuarit kanë organizuar lojëra të fatit pa ndërmarrje të regjistruar dhe pa leje në hapësirat në të cilat kanë kryer atë veprimtari.

Nga ana e MPB-së përkohësisht janë konfiskuar edhe mjete nga të denoncuarit: mjete financiare (mbi 50.000 denarë), dokumentacion (fletushka për pagesë, buletinë për lojëra fati dhe të tjera), si dhe 19 televizorë, 13 monitorë për kompjuterë, 11 kuti të kompjuterëve personalë, gjashtë aparate për tiketa, etj. *(U.H)*

Rreth 153 mijë të punësuar për dhjetë muaj!

Shkup, 24 dhjetor - Gjithsej 152.964 persona janë punësuar në Maqedoni në periudhën nga 1 janari deri më 31 tetor të këtij viti. Prej tyre, 63.461 persona janë punësuar në kohë të pacaktuar, ndërsa 89.503 në kohë të caktuar, treguan të dhënat e Agjencisë për Punësim të Maqedonisë. Nga të dhënat e publikuara në ueb-faqen e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, mund të shihet edhe se nga numri i përgjithshëm i të punësuarve paraprakisht në evidencën e APRM ishin 31.662 persona, ndërsa të tjerët aspak nuk kanë qenë në evidencën e personave të papunë. Në këtë evidencë për momentin si të papunë llogariten 102.100 persona. Pjesa më e madhe e tyre, gjegjësisht 44.259 persona, janë pa arsim ose me arsim fillor, me arsim jo të plotë të mesëm janë 14.359 persona, me arsim të mesëm të përfunduar 29.007, me arsim të lartë 1.656, ndërsa me arsim të përfunduar të lartë 11.914 persona, Në listën e personave të papunë ka edhe 868 persona me magjistraturë të përfunduar, si dhe 34 doktorë të papunë të shkencave.

PJESËMARRJA NËPËR KËSHILLAT E SHKOLLAVE DHE NË ORGANIZATA



NXËNËSIT SHUMË PAK TË ORGANIZUAR

"Mundohemi që të kemi përfaqësues në të gjitha shkollat e qytetit të Shkupit me qëllim të vënies së një komunikimi më të mirë, në kontekst të dërgimit dhe marrjes së informatave për çështje të cilat kanë të bëjnë me nxënësit e shkollave të mesme, për problematika që na takojnë të gjithëve", thotë Ylber Gashi, kryetari i UNSHM-së

Koha Laura PAPRANIKU

Shkup, 24 dhjetor - Organizimi i nxënësve brenda shkollave apo qoftë edhe aspiratat e tyre për t'u imponuar si faktorë në vendimet që sillen për ta, nuk është aspak në nivele të lakmueshme ashtu sikurse mungon edhe vullneti i tyre për të vepruar në kuadër të organizatave më të mëdha. I themeluar në janar të 2015-ës, Unioni i Nxënësve Shqiptarë të Shkollave të Mesme (UNSHM), për shembull, për momentin ka shtrirje në vetëm pak qytete të Maqedonisë dhe, megjithëse selia e tij është Shkupi jo të gjitha shkollat e mesme të kryeqytetit kanë anëtarë e tyre në këtë Unionin. Ndërkaq, këshillat e nxënësve, si brenda shkollave ashtu edhe në kryesitë e klasave, janë më tepër formale se sa kuptimplota.

Ylber Gashi, kryetar i UNSHM, thotë se pavarësisht përpjekjeve të cilat bëhen në drejtim të zgjerimit të unionit, ka ende shumë shkolla të mesme në Shkupit, ku UNSHM-ja nuk ka anëtarë të saj. Ndërkaq, shtrirja me degë nëpër qytete të tjera jashtë kryeqytetit, është ende më e vogël. "Përveç se në Shkup ku Unioni ka selinë e tij, kemi degë edhe në Tetovë, Prilep dhe Kumanovë", tregon Gashi, ndërsa thotë se qëllimi i UNSHM-së, është të jetë zëri i të gjithë nxënësve shqiptarë pavarësisht qytetit ku ata jetojnë. "UNSHM, prej themelit të vet ka pasur për qëllim të jetë zëri i të gjithë nxënësve shqiptarë kudo qofshin ato. Qëllimi ynë për ët ardhmen është t'i prezantojmë nxënësit kudo që janë, pra edhe të hapim degë të reja në

PËR 9 MUAJ JANË REALIZUAR 72.48 PËR QIND E TË HYRAVE NGA TVSH-ja

KORRIKU ME MË SHUMË HARXHIME

Të hyrat në arkën shtetërore nga TVSH-ja, sipas ekonomistëve, janë tregues i aktivitetit ekonomik të popullatës, gjegjësisht qytetarëve, edhe atë në funksion të harxhimeve të konsumit të përgjithshëm të qytetarëve

Shkup, 24 dhjetor - Për 9 muajt e parë të këtij viti, nga të hyrat neto nga TVSH-ja Ministria e Financave ka grumbulluar 35.55 miliardë denarë ose 576.26 milionë euro, që sipas ministrisë përkatëse, janë realizuar 72.48 për qind e të hyrave nga TVSH-ja nga sa janë planifikuar deri në fund të këtij vitit. Kështu tregojnë të dhënat e publikuara në ueb faqen e Ministrisë së Financave për realizmin e të hyrave në buxhet për këtë viti, që i bie se mesatarisht në muaj në arkën buxhetore nga TVSH-ja kanë hyrë 64 milionë euro. TVSH-ja është indikatori kryesor i harxhimeve të qytetarëve dhe në bazë të këtyre të dhënave të Ministrisë së Financave, del se më së shumti para qytetarët kanë harxhuar gjatë muajit korrik. Në muajin janar të hyrat në buxhet nga TVSH-ja kanë arritur shifrën prej 4.207 miliard denarë apo rreth 69 milionë euro Në muajin shkurt qytetarët e Maqedonisë nga harxhimet për konsum të përgjithshëm, kanë kontribuar që në arkën buxhetore të hynë nga TVSH-ja 3.682 miliardë denarë apo 59.6 milionë euro. Në muajin mars të hyrat nga TVSH-ja kanë arritur shifrën 4.277 miliardë denarë apo 69 milionë euro. Në muajin prill 4.387 miliardë, gjegjësisht rreth 70 milionë euro. Në muajin maj nga TVSH-ja janë inkasuar 4.295 miliardë denarë apo mbi 69 milionë euro. Në muajin qershor në kasën shtetëror kanë hyrë të hyra 2.540 miliardë denarë apo rreth 40 milionë euro. Në muajin korrik në arkën shtetërore qytetarët kanë injektuar 77,5 milionë euro vetëm nga tatimi i vlerës së shtuar

çdo qytet, mirëpo kjo varet nga rrethana të tjera që kanë të bëjnë me mundësitë dhe kohën", pohon ai.

Do të punojmë në mënyrë graduale dhe në drejtim të zgjerimit të degëve tona në qytete të tjera, plotëson më tej ai, ndërsa një gjë e tillë thotë se vlen edhe për zgjerimin e degëve në raport me shkollat e qyteteve ku ata veprojnë. "Mundohemi që të kemi përfaqësues në të gjitha shkollat e qytetit të Shkupit, me qëllim të vënies së një komunikimi më të mirë në kontekst të dërgimit dhe marrjes së informatave, për çështje të cilat kanë të bëjnë me nxënësit e shkollave të mesme, për problematika që na takojnë të gjithëve. Dëshirojmë që të dëgjohet zëri i UNSHM-së në të gjitha shkollat dhe të bëhemi pjesë e zgjidhjes së problemeve të tyre". Mirëpo, kryetari i UNSHM-së, thotë se diku kanë më shumë anëtarë e diku më pak.

"Ka shkolla ku, për fat të keq, nuk kemi asnjë anëtarët, prandaj do të vazhdojmë me përpjekjet që të shtrihemi më të gjitha shkollat e mesme të Shkupit dhe më gjerë, në çdo qytet. Për këtë kemi projekte të cilat kanë për qëllimi promovimin e UNSHM-së dhe besoj se do t'ia dalim të përfshijmë në anëtarësinë tonë nxënës nga të gjitha shkollat", shprehet Gashi, nxënës i Shkollës së Mesme "Maria Kiri Skllodovska" në Shkup.

Në shkollat e mesme, sipas tij, duhet të punohet shumë edhe në drejtim të organizimit të nxënësve brenda shkollave, si dhe rritjen e vetëdijes së tyre për pozita vendim marrëse. Nxënësit në përgjithësi janë të organizuar nëpër bashkësi, në kryesi klasash dhe shkollash, mirëpo nuk janë pjesë e vendimmarrjes. "Kryetarët, nënkryetarët dhe anëtarët e kryesive ekzistojnë më tepër formalisht.

Rrallë ndonjë shkollë ka këshill të nxënësve të organizuar mirë", thotë kryetari i UNSHM-së. Paralelisht problemeve tjera që tangojnë nxënësit e mesëm, rritja e peshës së nxënësve brenda vetë bashkësisë ku ata veprojnë, është sfidë për UNSHM-në. Lidhur me përfaqësimin mbi bazë të përkatësisë gjinore, për momentin ky union udhëhiqet nga femër vetëm në Tetovë. Në qytetet tjera (Shkup, Prilep dhe Kumanovë) kryetarët janë meshkuj. Mirëpo, kryetari i UNSHM-së, Gashi vëren se Kryesina e unionit dominohet nga gjinia femërore, pra siç thotë ai, në kryesinë e UNSHM-së më tepër ka femra sesa meshkuj.

(TVSH) dhe në këtë muaj janë realizuar të hyra më të mëdha në buxhet. Në muajin gusht të hyrat në buxhet nga TVSH-ja kapin shifrën prej 3.247 miliardë denarë ose rreth 55 milionë euro. Sipas këtyre të dhënave, më pak të hyra në buxhet nga TVSH-ja janë realizuar në muajin qershor, rreth 40 milionë euro, ndërsa në muajin korrik 77.5 milionë euro. Të hyrat në arkën shtetërore nga TVSH-ja, sipas ekonomistëve, janë tregues i aktivitetit ekonomik të popullatës, gjegjësisht qytetarëve, edhe atë në funksion të harxhimeve të konsumit të përgjithshëm të qytetarëve. Profesori i ekonomisë Hamit Aliu, shprehet se nëse i shohim të hyrat në buxhet sipas muajve, vërehet qartë se në muajin korrik arka shtetërore mbushet më së shumti.

"Kjo është edhe një e vërtet tjetër se mbushës më të mëdhenj të arkës shtetërore janë ata qytetarët që jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit. Korriku është muaji i pushimeve kur mërgimtarët vijnë në vendlindje. Pjesa më e madhe e këtyre mërgimtarëve janë shqiptarë, të cilët gjatë kohës sa rrinë për pushime në familjet e tyre, harxhojnë më shumë para për blerje të mallrave të ndryshme, pastaj janë dasmat e kështu me radhë. Pra, kjo fletë qartë se shqiptarët janë mbushës më të mëdhenj të arkës shtetërore", thotë Aliu. Edhe Arben Halili, ekspert ekonomik, shprehet se buxheti mbushet nga tatimet dhe pjesa ma e madhe e të hyrave në buxhet janë nga TVSH-ja, gjegjësisht para të qytetarëve si shpenzues më të mëdhenj të konsumit të përgjithshëm. "Pa dyshim se pjesa më e madhe e të hyrat në arkën shtetërore janë të hyra nga paratë e qytetarëve për shpenzimet që ata bëjnë për blerje të mallrave të ndryshme. Këto para që grumbullohen nga TVSH-ja e qytetarëve dhe kompanive, rreth 50 për qind shkojnë për pagesa të pensioneve, transfertave sociale, ndërsa shumë pak destinohen për zhvillim ekonomik apo për investime kapitale", thotë Arben Halili, ekspert ekonomik. *(Z.V)*

TRANSPORTI NË MAQEDONI

Veçori e transportit në Maqedoni është edhe ulja e bartjes së udhëtarëve dhe mallrave përmes hekurudhës dhe transporti publik në Shkup si dhe stërmbushja e rrugëve me automjete, kamionë dhe autobusë

RRITET NUMRI I VETURAVE, ULET TRANSPORTI HEKURUDHOR DHE URBAN

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 24 dhjetor - Në numrin e përgjithshëm të transportit dominon ai me vetura të pasagjerëve me 77 për qind, në raport me llojet e tjera të transportit. Pjesa tjetër e mbetur prej 22.1 për qind, përbëhet nga transporti me autobusë dhe vetëm 0.9 për qind merr pjesë transporti hekurudhor.

Statistika më tej zbardh se në pesë vitet e kaluara është rritur dukshëm numri i mjeteve të ndryshme transportuese në rrugët e Maqedonisë. Për 100 mijë është rritur vetëm numri i veturave ose nga 301.761 vetura të regjistruara në vitin 2012, në 394 934 vetura në vitin 2016. Është rritur nga 2719 në 3230 edhe numri i autobusëve si dhe ai i kamionëve prej 26.542 në 34.669 kamionë përgjatë periudhë 2012-2016. Me fjalë të tjera, është rritur nga 344.773 në 461.799 numri i mjeteve të ndryshme transportuese që qarkullojnë nëpër rrugët e Maqedonisë.

Njëherazi veçori tjetër e transportit në Maqedoni, është edhe ulja e bartjes së udhëtarëve dhe mallrave përmes hekurudhës dhe stërmbushja e rrugëve me automjete, kamionë dhe autobusë.

"Transporti rrugor shënon rritje prej 93.2 për qind në vitin 2012, në 96.9 për qind në vitin 2016, ndërsa transporti hekurudhor shënon rënie prej 6.8 për qind në vitin 2012, në 3.1 për qind në vitin 2016.", tregojnë të dhënat statistikore.

Në Maqedoni, ngjashëm me shtetet fqinje, për dallim prej shteteve evropiane, hekurudha shumë pak përdoret si mjet transportues për pasagjerët, për shkak të ngecjes në modernizimin e binarëve dhe trenave që akoma nuk udhëtojnë me shpejtësi më të mëdha. Ekspertët e komunikacionit thonë se hekurudhat, në raport me mjetet e tjera transportuese, ka më shumë përparësi, siç janë kapacitete të mëdha me harxhim të vogël të energjisë, mbrojtja e ambientit jetësor, përqindje e madhe e sigurisë, qasje e shpejtë dhe e lehtë prej një vendi në vend tjetër, por megjithatë shtojnë se ekzistojnë edhe mangësi në përdorimin e tyre në shtetet me ekonomi të dobëta, siç janë harxhime të mëdha për ndërtimin dhe mirëmbajtjen, sistemet e ndërlikuara teknologjike etj.

> **Në vitin 2015, është ulur numri i udhëtarëve në raport me vitin 2012 për 1.3 për qind, është ulur numri i biletave të shitura për 9 për qind, ndërsa numri i kilometrave të kaluara është rritur për 6.8 për qind**

Në shtetet evropiane, në 30 vitet e fundit, me të madhe janë në përdorim trenat si mjet transportues më i shpejtë dhe më efikas se veturat. Për shembull, distanca në Gjermani, midis Kelnit dhe Munihut, me veturë përshkohet për dy orë, ndërsa me tren të shpejtë që vozitë deri në 300 kilometra në orë, arrihet për një orë. Treni më i shpejtë italian është " Le Frecc", ose në përkthim SHIGJETA që arrin shpejtësi deri në 300 kilometra në orë, duke lidhur qytetet e rëndësishme italiane si Torino-Milano-Bolonja- Firenca-Roma-Napoli dhe nga Bolonja deri në detin Adriatik ose Bolonja- Rimini- Ankona me 87 linja ditore.

Pionierët e trenave të shpejtë në botë janë japonezët, që planifikojnë deri në vitin 2027 të vendosin linjë të trenave me magnet ndërmjet Tokios dhe Nagojës. Rruga prej 280 kilometra, duhet të zgjasë vetëm 40 minuta, duke arritur shpejtësi maksimale deri në 505 kilometra në orë.

Në ndërkohë, për dallim prej shteteve evropiane që stimulojnë përdorimin e transportit publik jo vetëm në kryeqytet, por edhe në qendrat më të vogla urbane, në Maqedoni jo vetëm që rritet përdorimi i veturave në raport me transportin publik , por edhe transporti publik mungon si mundësi shfrytëzimi në gati të gjitha qytetet në vend. Bile, në Shkup edhe autobusët e rinj nuk e kanë zgjidhur problemin me transportin publik, por përkundrazi ato janë shtjelluar më tej, konstaton raporti i Entit Shtetëror për Revizion kushtuar punës së Ndërmarrjes publike të Transportit për vitin 2015. "Edhe pse NPT ka park vozitës të rinovuar, megjithatë treguesit e punës së saj tregojnë rezultate që janë të kundërta me ato që priteshin. Indikatorët e punës së kësaj ndërmarrjeje lidhur me përmirësimin e transportit urban publik, përmirësimit të shërbimit dhe cilësisë tregojnë më shumë kilometra të kaluara, por me tendencë të uljes së numrit të pasagjerëve të transportuar, të biletave të shitura dhe pasagjerëve të transportuar me kilometra të kaluar", thekson raporti. Në vitin 2015, është ulur numri i udhëtarëve në raport me vitin 2012 për 1.3 për qind, është ulur numri i biletave të shitura për 9 për qind, ndërsa numri i kilometrave të kaluara është rritur për 6.8 për qind.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – Teksti i pastruar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167/2015) dhe vendimit të drejtorit të Shkollës së mesme ekonomike dhe juridike të Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov – Shkup, publikohet

SHPALLJE
Për plotësimin e vendeve të punës për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018

1. Një mësimdhënës të gjuhës gjermane për 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara nga gjuha dhe letërsia gjermane – drejtimi mësimor, studime të mbaruara nga gjuha gjermane - drejtim tjetër me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucion të akreditua për arsim sipëror, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

2. Një mësimdhënës të gjuhës shqipe për 21 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga gjuha dhe letërsia shqipe – drejtimi mësimor, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

3. Një mësimdhënës të informatikës për 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga informatika – drejtimi mësimor dhe drejtime aplikative me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, matematikë – informatikë drejtimi mësimor, teknika kompjuterike, informatikë dhe automatikë me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, studime të mbaruara diplomike nga sfera e informatikës, teknologjive informatike ose informative-komunikimit në universitetet e akredituara të RM ose jashtë vendit me akreditim në vend dhe me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

4. Një mësimdhënës të informatikës për 12 orë mësimore gjegjësisht 24 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga informatika – drejtimi mësimor dhe drejtime aplikative me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, matematikë – informatikë drejtimi mësimor, teknika kompjuterike, informatikë dhe automatikë me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, studime të mbaruara diplomike nga sfera e informatikës, teknologjive informatike ose informative-komunikimit në universitetet e akredituara të RM ose jashtë vendit me akreditim në vend dhe me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, me neto pagesë bazë në shumë prej 12.913,00 denarë.

5. Një mësimdhënës të historisë së Maqedonisë për 12 orë mësimore gjegjësisht 24 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga historia – Instituti për histori, me neto pagesë bazë në shumë prej 12.913,00 denarë.

6. Një mësimdhënës të gjeografisë ekonomike për 8 orë mësimore gjegjësisht 16 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga gjeografia, drejtimi mësimor, me neto pagesë bazë në shumë prej 8.609,00 denarë.

7. Një mësimdhënës të matematikës për 21 orë mësimre gjegjësisht 40 orë punë në javë prë kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për matematikë, drejtimi mësimor; studime të mbaruara për matematikë, drejtimi teorik; studime të mbaruara për matematikë, drejtimi aplikativ me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike; studime të mbaruara për matematikë – informatikë, drejtimi mësimor, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

8. Një mësimdhënës të psikologjisë afariste për 8 orë mësimore gjegjësisht 16 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga psikologjia, pedagogjia dhe pedagogjia me filozofi, me neto pagesë bazë në shumë prej 8.609,00 denarë.

9. Një mësimdhënës të edukatës muzikore për 8 orë mësimore gjegjësisht 16 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime në Fakultetin për edukatë muzikore – departamenti për teori dhe pedagogji muzikore, Fakultet të edukatës muzikore (departamente të tjera) me derikualifikim pedagogjik në Fakultetin për edukatë muzikore, me neto pagesë bazë në shumë prej 8.609,00 denarë.

10. Një mësimdhënës të artit figurativ për 8 orë mësimore gjegjësisht 16 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime në Fakultetin për art figurativ – departamenti pedagogjik, Fakulteti për art figurativ me provim të dhënë në fakultetin amë për kryerje të veprimtarisë pedagogjike, me neto pagesë bazë në shumë prej 8.609,00 denarë.

11. Një mësimdhënës të edukatës qytetare për 10 orë mësimore gjegjësisht 20 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara nga sociologjia, filozofia, pedagogjia dhe historia, me neto pagesë bazë në shumë prej 10.761,00 denarë.

12. Një mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë maqedonase për nxënësit e bashkësive të tjera për 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me fakultet të mbaruar filologjik (ish fakulteti filozofik), grupi: Gjuhë maqedonase me histori të letërsisë maqedonase dhe popujve të tjerë jugosllav, Historia e letërsisë maqedonase dhe historia e letërsisë së popujve të tjerë jugosllav me gjuhë maqedonase, letërsia krahasimtare – drejtimi mësimor, Gjuhë dhe letërsi maqedonase ose gjuhë maqedonase dhe letërsi maqedonase ose gjuhë maqedonase, gjuhë dhe letërsi serbe – drejtimi mësimor, Letërsia maqedonase dhe letërsia jugosllave me gjuhë maqedonase si lëndë e dytë kryesore (ish grupi historia e letërsisë së popujve të RSFJ) - drejtimi mësimor, grupi studimor për letërsi të përgjithshme dhe krahasimtare (kuadrot që kanë mbaruar deri në vitin 1993), grupi studimor për letërsi të përgjithshme dhe krahasimtare - drejtimi mësimor, grupi studimor për letërsi të përgjithshme dhe krahasimtare – drejtim tjetër me përgatitje të fituar përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike në fakultet përkatës, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

13. Një mësimdhënës të lëndëve juridike për 9 orë mësimore gjegjësisht 18 orë punë në javë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, për mësimin në gjuhën maqedonase, me studime të mbaruara për drejtësi, me neto pagesë bazë në shumë prej 9.685,00 denarë.

14. Katër mësimdhënës të lëndëve ekonomike për 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, për mësimin në gjuhën shqipe, me studime të mbaruara për ekonomi, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

15. Një mësimdhënës të lëndëve ekonomike për 12 orë mësimore gjegjësisht 24 orë punë në javë, për kohë të caktuar për mësimin në gjuhën shqipe si zëvendësim të puntorit i cili punon me orar të shkurtuar të punës deri në kthimin e tij, por jo më gjatë se deri më 31.08.2018, me studime të mbaruara për ekonomi, me neto pagesë bazë në shumë prej 12.913,00 denarë.

16. Një mësimdhënës të lëndëve ekonomike për 21 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë, për kohë të caktuar për mësimin në gjuhën shqipe për kohë të caktuar deri më 31.08.2018, me studime të mbaruara për ekonomi, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë. 17. Një mësimdhënës të lëndëve juridike për 20 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë, për kohë të caktuar për mësimin në gjuhën shqipe për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 me studime të mbaruara për drejtësi, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

18. Një mësimdhënës të lëndëve juridike për 21 orë mësimore gjegjësisht 40 orë punë në javë, për kohë të caktuar për mësimin në gjuhën shqipe për kohë të caktuar deri më 31.08.2018 me studime të mbaruara për drejtësi, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

19. Një pedagog me orar të plotë të punës gjegjësisht 40 orë punë në javë, për kohë të caktuar për mësimin në gjuhën maqedonase për zëvendësim të drejtorit deri në kthimin e tij, por jo më gjatë se deri më 31.08.2018, me fakultet të mbaruar filozofik, grupi pedagogji, me neto pagesë bazë në shumë prej 21.522,00 denarë.

Kandidatët për mësimdhënës nën pikat 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të kenë përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike.

Orari i punës së mësimdhënësve është në dy ndërrime edhe atë në ndërrimin e parë prej ora 7,30 deri në ora 13,20, ndërsa në ndërrimin e dytë prej ora 13,30 deri në ora 19,20 në pajtim me orarin e orëve.

Orari i punës për vendin e punës së pedagogut është në dy ndërrime, prej ditës së hënë deri ditën e premte, fillimi dhe mbarimi i orarit ditor të punës në ndërrimin e parë është prej ora 7,30 deri në ora 15,30, ndërsa në ndërrimin e dytë është prej ora 11,20 deri në ora 19,20.

Kandidatët për mësimdhënës duhet të njohin gjuhën letrare dhe alfabetin e gjuhës në të cilën zhvillohet mësimi për çka do të bëhet kontrollim nga komisioni në shkollë, edhe atë për ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e theksuara në shpallje, ndërsa për terminin e kontrollimit do të informohen enkas me e-mail.

Dokumentet e nevojshme:

* Lutje me CV;
* Diplomë për arsimin e mbaruar përkatës (të vërtetuar në noter);
* Certifikatë të shtetësisë;
*Certifikatë se kanë përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike (për kandidatët me studime të mbaruara që nuk kanë drejtim mësimor).

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet dorëzohen në adresën në vijim: Shkolla e mesme ekonomike dhe juridike e Qytetit të Shkupit "Arseni Jovkov"- Shkup, rr "Kosturska" pn – Shkup, tel. 02/2611-195, personi për kontakt është sekretari i shkollës.

SHMEJQSH "Arseni Jovkov" – Shkup

REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16") dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15"), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16") dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15"), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 42/2017

për punësimin e 1 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Prilepit "për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V01000 Këshilltar për udhëheqjen e procedurave lidhur me menaxhimin, administrimin dhe evidentimin e pronës së patundshme të Komunës, Njësia për udhëheqjen, administrim, dhe evidentimin e pronës së patundshme në pronësi të Komunës, Sektori për urbanizëm, punë komunale dhe mbrojtjen e mjedisit hapësinor. — 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:
- nilevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Arkitekturë, Urbanizëm dhe planifikim, Ndërtimtari dhe ekonomizim të ujit.
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përmes posedimit të certifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose certifikatë Gete.

njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të certifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë certifikatë me STANAG 1+1+1+1+

Orari i punës :
- Ditët e punës e hënë -e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 24.972,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2017 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Faza e 4 – të: Testi i personalitetit realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të fazës së 3 – të.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gaz. Zyrtare e RM. Nr. 74/15), pëlqimit të dhënë nga MASH nr. 12 – 10666/4 prej 02.10.2017 – financim i ri, pëlqimit nga MASH nr 12 – 8261/3 prej 11.12.2017 financim i vjetër si dhe sistematizimit të vendeve të punës,Drejtori i sh.f."LIRIA"fsh. Jabollçisht i Epëm komuna e Çashkës, shpall këtë

K O N K U R S
Për plotësimin e vendeve të lira të punës me kohë të caktuar/kufizuar deri më 31.08.2018 për vitin shkollorë 2017/2018

I ShF "Liria" Jabollçishtë i Epërm me mësim në gjuhë shqipe

1. Arsimtarë i grupit klasorë - 6 realizues
2. Arsimtarë të matematikës - 2 realizues
3. Arsimtarë i gjuhës maqedone - 1 realizues
4. Arsimtarë të gjuhës angleze - 4 realizues
5. Arsimtarë i gjuhës frënge - 1 realizues
6. Pedagog - 1 realizues
7. Arsimtarë i arsimit figurativ - 1 realizues (plotësim me lëndë tjera)
8. Arsimtarë i arsimit muzikorë - 1 realizues (plotësim me lëndë tjera)
9. Arsimtarë i etikës dhe religjionit - 1 realizues (plotësim me lëndë tjera)

II Shp-Jabollçishtë i Poshtëm me mësim në gjuhën shqipe

1. Arsimtarë për grupin klasor - 2 realizues

Kushtet: Krahas kushteve të parapara me LMP kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet në përputhje me nenin 80 nga Ligji për arsim fillor (Gz. Zyr. RM. 103/08)

Konkursi do te jete i hapur 5 (pesë) dite pune nga dita e shpalljes

Dokumentet e nevojshme:

1. Lutje
2. Diploma për arsimin adekuat –VII//1
3. Certifikata e shtetësisë të RM

Dokumentacioni i pakompletuar dhe jo ne kohe i dorëzuar nuk do të merret në shqyrtim

Kandidatët dokumentet ti dërzojn në adresën: Shkolla fillore "Liria"

Fsh. Jabollçishtë i Epërm –Komuna e Çashkës. Tel. 043/244 501 mob. 072 220 010

Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 167/2015, dhe 27/2016) dhe neni 82 paragrafi 1 dhe 3 nga Ligji për arsim fillor (Gazeta zyrtare nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 98/ 2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016. 67/2017), dhe me miratim nga Ministria për arsim dhe shkencë nr. 12-10810/3 prej 12.12.2017 dhe Shqyrtimi nr 1 për punësim për kohë të caktuar, SHFK "Llazo Trpovski"-Shkup, shpall:

SHPALLJE PUBLIKE
Për nevojën për punësim për vitin shkollor 2017/2018

SHFK "Llazo Trpovski"- Shkup- për vitin shkollor 2017/2018 ka nevojë për:

1. Mësimdhënës i grupit klasor 4 pozita prej të cilave 3 për punësim për kohë të caktuar më së voni deri më 31.08.2018, ndërsa 1 pozitë si zëvendësim për mësimdhënësen pushim të lindjes deri në kthimin e saj, ndërsa më së voni deri më 31.08.2018.

Mësimdhënës i grupit klasor me orar të plotë prej ora 08.00 deri në përfundimin e orëve mësimore, prej të hënës deri të premten, me arsim të nivelit VII/1 (Profesor i diplomuar i arsimit klasor apo Pedagog i diplomuar). Mësimdhënësit kanë të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në përputhje me Ligjin për marrëdhënie pune dhe me pagë neto prej 20.644,00 denarë. Më lutjet duhet të bashkëngjiten dokumentet në vazhdim:

- CV
- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë
- diplomë për arsim të kryer përkatës
- të njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik
- të ketë të dhënë provim profesional për mësimdhënës, provim profesional për edukatorë, (me përjashtim për kandidatët të cilët kanë status praktikant).

Lutjet më dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen deri të SHFK "Llazo Trpovski"-Shkup, rr. "Radika" nr. 9, 1000 Shkup, origjinal apo të notarizuara. Personi për kontakt nr. tel. 02/ 3071-656.

Shpallja zgjatë 5 ditë punë prej ditës së publikimit, ndërsa zgjedhja do të bëhet në afat prej 15 ditë pune.

Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh.

SHFK "Llazo Trpovski"-Shkup
Drejtor
Mr.Eleonora Strezovska

ME GJASË, EDHE NJË MANDAT DO TË KALOJË ME EMRA MONIST TË SHKOLLAVE SHQIPE

S'KA KUSH E HEQ PEJÇINOVIQIN E TETOVËS

Me gjasë, nxënësit shqiptarë të gjimnazit "Kiril Pejçinoviq", të tekstilit "Gjoce Stojçevski", të mjekësisë "Nikolla Shtejn", të bujqësisë "Mosha Pijade", edhe shumë vite do të presin ndryshimet e emrave të shkollave, që assesi nuk po ndodhin

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 24 dhjetor - Mosformimi i Këshillit në Komunën e Tetovës edhe sivjet mban peng ndryshimin e emrave të rrugëve dhe shkollave, të cilët gjatë katër viteve të kaluara - nuk u gjendën në asnjërën prej seancave të Këshillit. Ndryshimi i emrave të disa shkollave të mesme dhe fillore në Tetovë, edhe pse është inicuar disa herë nga disa drejtorë të shkollave, megjithatë këto kërkesa nuk arritën të jenë në rend dite para këshilltarëve qoftë edhe për debat dhe më pas edhe për miratim. Mospasja e një konsensusi mes shumicës në ish-përbërjen e Këshillit të Komunës së Tetovës, gjegjësisht këshilltarëve të VMRO-së dhe BDI-së, kishte bërë që kjo çështje të mos debatohet me arsyetimin se duhet një klimë më pozitive në tërë vendin për të ndryshuar emrat e shkollave apo rrugëve. Ishkryetari i Këshillit të Komunës së Tetovës, Isen Xhemaili, pati thënë se kjo pikë nuk ishte vendosur në rend dite për shkak se gjatë tërë mandatit ka patur probleme tjera lokale, kurse po ashtu vendi ka patur edhe shumë tensione etnike dhe politike që kanë ndikuar që kjo pikë të mos del në rend dite. Për ndryshimin e këtyre emrave duhet që në Këshillin komunal të Tetovës të sillet vendim me parimin e Badenterit, që do të thotë shumica e këshilltarëve maqedonas të votojnë pro këtij vendimi. Në bazë të kësaj dhe duke llogaritur numrin e këshilltarëve që ka VMRO-ja, gjegjësisht pesë këshilltarë dhe LSDM tre, është shumë e vështirë që të ketë ndryshime të emrave, pasi edhe në këtë përbërje të re të këshillit të Komunës së Tetovës, VMRO ka shumicën e këshilltarëve të nacionalitetit maqedonas, parti kjo e cila disa herë ka bojkotuar seancat edhe në të kaluarën, duke mos përkrahur asnjë vendim të Komunës së Tetovës. Drejtorët e shkollave të mesme kohë më parë janë shprehur se nuk kanë asgjë kundër emrave aktual të shkollave, por është kërkesë e nxënësve dhe prindërve që shkollat të mbajnë emër të ndonjë personaliteti shqiptar. "Sa i përket emërimit të shkollave, dihet se është e drejtë ligjore e themeluesit të shkollave, por kemi të bëjmë me një absurd, pasi ndërrohet sistemi shoqëror ku të gjithë shkollat mbajnë emra të përcaktuar nga ish-sistemi monist dhe me të njëjtat emra të shkollave vazhdohet e që nuk paraqesin realitetin etnik apo multietnik të shkollave. Një ndër ato shkolla është edhe shkolla e mesme, siç njihet në opinion, shkolla e mesme tekstile me emrin 'Gjoce Stojçevski', që ne nuk kemi asgjë kundër këtij emri, por kërkesa e nxënësve, kërkesa e prindërve, ai dhe kërkesa e kuadrit edukativo-arsimorë është që shkolla të emërohet me një emër që do të paraqet realitetin e strukturës dhe përbërjes së nxënësve, realitetin etnik në shkollë, dhe pikërisht iniciativa që ka rrjedh nga Këshilli i prindërve, nga Këshilli arsimtarëve dhe Forumi Rinor i Nxënësve është përcjellë deri tek themeluesi dy herë, mirëpo për shkak të rrethanave siç janë deklaruar edhe organet kompetente, nuk ka ardhur në rend të ditës", deklaroi Abaz Abazi, drejtor i shkollës së mesme Tekstile. Me gjasë, nxënësit shqiptarë në gjimnazin e Tetovës "Kiril Pejçinoviq", ata të shkollës së Mesme Komunale Tekstile "Gjoce Stojçevski", të shkollës së Mjekësisë "Nikolla Shtejn", të shkollës së Bujqësisë "Mosha Pijade", edhe shumë vite do të presin ndryshimet e emrave të shkollave. Përndryshe, aktalualisht në Tetovë vetëm gjimnazi "7 Marsi" i themeluar para tre vitesh mban emrin që ndërlidhet me datë historike për shqiptarët, kurse shkollat tjera nuk kanë asgjë të përbashkët me të kaluarën e shqiptarëve në Tetovë.

> **Në bazë të kësaj dhe duke llogaritur numrin e këshilltarëve që ka VMRO-ja, gjegjësisht pesë këshilltarë dhe LSDM tre, është shumë e vështirë që të ketë ndryshime të emrave, pasi edhe në këtë përbërje të re të këshillit të Komunës së Tetovës, VMRO ka shumicën e këshilltarëve të nacionalitetit maqedonas**

LAJME SHKURT

Baftiu promovoi librin "Nga xhepi i zemrës"

Shkup, 24 dhjetor - "Nga xhepi i zemrës" është libri i dytë me poezi i poetes se re nga Shkupi, Arlinda Baftiu që të shtunën mbrëma u promovua në Qendrën teatrore për fëmijë. Librin e parë "Luftë me heshtjen" poetja Baftiu e ka botuar në vitin 2015 nga konkursi i Shtëpisë së Kulturës, Koço Racin. Poetja në promovim theksoi se tematika e 64 poezive të përmbledhura në "Nga xhepi i zemrës" është laramania e muzave, emocioneve, problematikave dhe e dukurive të shoqërisë sonë. "Meqë 'Nga xhepi i zemrës' është shpërblim i çmimit të parë të festivalit 'Ditët e poezisë shqip', fillon me poezinë fituese të festivalit, 'Andakarna', që ka për temë transformimin e Shkupi 2014. Në pjesën e parë të librit janë poezi të frymëzuara nga gratë dhe trajtojnë temën e lirisë. Një pjesë e madhe e poezive janë dedikime për njerëzit që më kanë frymëzuar dhe pjesa tjetër e poezive janë gjuha ime e protestës për dukuritë sociale", deklaroi në promovim poetja Arlinda Baftiu. Redaktor i poezive të Baftiut dhe njëherit kritik letrar, Ahmet Selmani, në fjalën e tij theksoi se nga libri i parë në të dytin ka rritje estetike të poetes. Recezentja e librit Vjollcë Berisha, poete dhe pedagoge pranë USHT-së në promovim tha se libri i Arlindës bën pjesë në grupin e librave që dëshiron t'i rikthehesh për ta lexuar.

Niveli i ujit në lumenj, nën mesataren

Shkup, 24 dhjetor - Përveç niveleve të Vardarit në Veles dhe të Drinit të Zi në Lozhan, niveli i ujërave te të gjithë lumenjtë tjerë në shtet është nën mesataren për dhjetorin. Sipas matjeve të sotme të bëra nga DPHM, niveli i Cërna Rekës në Novaci dhe i Sateska në Botun është dyfish më i ulët nga mesatarja për dhjetorin. Niveli i ujit në Liqenin e Dojranit, Ohrit dhe Prespës është në korniza të mesatares për dhjetorin.

Më ftohë dhe më shumë borë në Mavrovë

Shkup, 24 dhjetor - Më ftohtë mëngjesin e sotëm do të jetë në Mavrovë me shtatë gradë nën zero. Temperatura nën zero do të ketë edhe në Krushevë (-5), Pretor, Ohër, Dibër dhe Manastir (-3), Tetovë, Berovë, Prilep, Vinicë dhe Pozharan, ndërsa një gradë nën zero do të ketë në Kriva Pallankë, Gjurishte dhe Topolçan. Zero gradë në mëngjes pritet të matën në Strumicë, një gradë në Shkup, dy gradë në Kumanovë, katër në Shkup, Demik Kapi, Dojran dhe Shtip dhe temperaturë më të lartë prej gjashtë gradë në Gjevgjeli. Në Mavrovë ka edhe më së shumti borë, nëntë centimetra, në Krushevë dy, dhe nga një centimetër shtresë e borës në Berovë dhe Kriva Pallankë. Deri në fund të ditës, moti do të jetë i vranët me periudha të diellit, pasdite vranësira do të ulet. Do të fryjë erë mesatare veriperëndimore, e cila përgjatë Luginës së Vardarit do të forcohet. Deri të mërkurën, moti do të jetë stabil dhe i thatë, me rritje të temperaturës së ditës. Të martën dhe të mërkurën nëpër disa lugina do të ketë kushte për paraqitjen e mjegullës dhe vranësira të dobëta, ndërsa në vendet më të larta dhe në malet do të fryjë erë kryesisht nga drejtimi veriperëndimor dhe do të ketë vranësira mesatare.

Strategjia "përça dhe sundo" e Putinit të Moskës

Nga Janusz BUGAJSKI

Një strategji fitimprurëse, e ndjekur nga Moska për të nënshtruar fqinjët e saj, është politika klasike perandorake e përçarjes dhe sundimit. Edhe pse Kremlini mund të mos sundojë vendet që i nënshtron, duke i vendosur fqinjët kundër njëri-tjetrit, mund të dobësojë mbrojtjen e tyre, të "injektojë" veten në vendimet e tyre të politikës së jashtme, si dhe të parandalojë shfaqjen e një fronti të përbashkët shumëkombësh që t'ii kundërvihet politikave të Rusisë.

Strategjia e "përçarjes dhe sundimit" të Moskës përreth kufijve të saj, është aq shumë e përhapur, sa që do të duhej një raport i gjatë për të përshkruar të gjitha rastet dhe mënyrat. Megjithatë, Kremlini ka synuar të paktën katër marrëdhënie dypalëshe aktuale në rajon, ose duke dobësuar kundërshtarët e tij, ose duke kontrolluar aleatët e tij ngurrues: Poloni-Ukrainë, Bjellorusi-Ukrainë, Hungari-Ukrainë dhe Armeni-Azerbajxhan. Që nga pushtimi i Ukrainës, propaganda e sponsorizuar nga Rusia, është përqendruar në minimin e marrëdhënieve midis Ukrainës dhe fqinjëve të saj perëndimorë, për të izoluar dhe destabilizuar vendin. Polonia dhe Hungaria, kanë qenë dy objektivat kryesorë të ofensivës së Moskës. Në rastin e Polonisë, deklaratat politike të gjeneruara nga Moska, raportet e medias dhe rrjetet sociale u fokusuan tek mosmarrëveshjet e vazhdueshme historike ndërmjet Varshavës dhe Kievit, në mënyrë që të dobësonin mbështetjen e Polonisë ndaj pavarësinë e Ukrainës, dhe vetë-mbrojtjes së saj kundër agresionit rus.

Për polakët, Moska e vë theksin tek ngjarjet e Volinit gjatë Luftës së Dytë Botërore, në të cilën disa guerilje nacionaliste ukrainase vranë qindra civilë polakë. Për ukrainasit, Moska fokusohet në zhvendosjen e detyruar pas luftës nga ana e Varshavës të civilëve ukrainas, nga territoret lindore të Polonisë. Qëllimi është të rriten ndjenjat nacionaliste në të dyja shtetet, dhe të tregohet se polakët janë pashmangshmërisht anti-ukrainas, dhe ukrainasit janë në thelb anti-polakë. Televizonet ruse, kanë inskenuar edhe incidente të nacionalistëve polakë, që pretendohej se po digjnin flamujt ukrainas gjatë festimeve të Ditës së Pavarësisë së Polonisë, në mënyrë që të ngjallnin armiqësinë ukrainase kundër polakëve. Në një shembull tjetër të kultivimit të mosmarrëveshjeve në lagjen e tij, Kremlini inkurajon Budapestin të bëjë fushatë ndaj pakicës hungareze në rajonin Transkarpatia në Ukrainë. Ai përforcon pretendimin se Kievi, po ndjek politika diskriminuese, si dhe përhap propagandën e disa anëtarëve të komunitetit rutenian në Transkarpatia, për autonomi rajonale ose pavarësi të plotë. Moska e përshkruan Ukrainën si një shtet të dështuar, duke pretenduar se ajo përballet me probleme gjithnjë e më serioze etnike në Transkarpatia dhe rajone të tjera përgjatë kufijve të saj. Strategjia e Kremlinit synon të ushtrojë presion mbi Kievin, duke i portretizuar hungarezët në Ukrainë si potencialisht jobesnikë ndaj shtetit, duke nxitur konfliktet ukrainase-hungareze, si dhe duke minuar një front të përbashkët të Vishegradit që kundërshton politikën ruse ndaj Ukrainës. Mediat propagandistike të Rusisë, janë përpjekur gjithashtu të prishin marrëdhëniet midis Ukrainës dhe Bjellorusisë. Ato pretendojnë në mënyrë të vazhdueshme, se militantët ukrainas po depërtojnë në Bjellorusi, për të organizuar një revoltë të llojit Euromaidan në Minsk. Kremlini po kryen gjithashtu provokime të drejtpërdrejta, sikurse ishte arrestimi së fundmi i një gazetari ukrainas në Minsk, që thuhet se është inskenuar nga Shërbimi Federal i Sigurisë Federale (FSB). Gazetari u akuzua për spiunazh, pasi iu kapën dokumente të falsifikuara nga stafi i një ekipi televiziv rus NTV, që zbulonin se Minsku do të lejonte që territori bjellorus të përdoret nga forcat ruse në luftën e saj kundër Ukrainës. Kaukazi i Jugut, ofron shembullin më të qartë të strategjisë "përça e sundo" nga ana e agjencive ruse: konflikti mes Azerbajxhanit dhe Armenisë. Moska furnizon të dyja palët me armë, dhe e përdor konfliktin për të mbajtur nën kontroll Jerevanin dhe Bakunë. Që nga fillimi i viteve 1990, Moska ka penguar çdo lloj zgjidhje të konfliktit të Nagorno-Karabakut, dhe mosmarrëveshjeve rreth territoreve fqinje azere të pushtuara nga forcat armene. Objektivi i Moskës, është të parandalojë që të dyja vendet të lëvizin në një mënyrë gjeopolitike drejt Perëndimit, duke siguruar që ato të mbeten brenda orbitës ruse. Duke ndihmuar pushtimin armen të Nagorno-Karabakut, Kremlini e kërcënon Azerbajxhanin me ndarjen e vendit, nëse qeveria azere do të afrohet më shumë me institucionet perëndimore. Në të njëjtën kohë, e shpërblen Armeninë për marrëdhëniet e saj me Moskën, por kërcënon të tërheqë një mbështetje të tillë, nëse Jerevani do të zhvillonte lidhje me BE-në dhe NATO-n. Kremlini mund të manipulojë grindje të tjera, për të avancuar axhendën e tij, dhe trazuar institucionet ndërkombëtare. Tensionet e fshehta midis Serbisë dhe Kroacisë, Malit të Zi apo Kosovës, midis Maqedonisë dhe Greqisë, Rumanisë dhe Moldavisë, apo midis Rumanisë dhe Hungarisë mund të riushqehen nga propaganda dhe provokimet ruse. Dhe çështja e pakicave brenda shteteve të shumta në Evropën Qendrore dhe Juglindore, mund të ndizet aq sa të përshkallëzohet në një konflikt. Për të kundërshtuar strategjinë "përça e sundo", dhe për të shmangur rënien në kurthet e Moskës, çdo qeveri e shënjestruar prej saj duhet të ndjekë tri politika. Së pari, ato duhet të rrisin ndërgjegjësimin e publikut për dobësitë politike dhe informative, ndaj sulmeve të frymëzuara nga Kremlini. Së dyti, mund të krijojnë grupe pune dypalëshe me shtetet fqinje, të përbëra nga studiues dhe specialistë për të monitoruar, ekspozuar dhe korrigjuar propagandën e huaj përçarëse.

Strategjia e "përçarjes dhe sundimit" të Moskës përreth kufijve të saj, është aq shumë e përhapur, sa që do të duhej një raport i gjatë për të përshkruar të gjitha rastet dhe mënyrat. Megjithatë, Kremlini ka synuar të paktën katër marrëdhënie dypalëshe aktuale në rajon, ose duke dobësuar kundërshtarët e tij, ose duke kontrolluar aleatët e tij ngurrues: Poloni-Ukrainë, Bjellorusi-Ukrainë, Hungari-Ukrainë dhe Armeni-Azerbajxhan

Dhe së treti, ata mund ta përdorin në mënyrë konstruktive ndërhyrjen e Moskës, si një mundësi për të zhvilluar nisma rajonale, veçanërisht në sferën informative. Kjo mund të përfshijë bashkëpunimin midis mediave, tryezat e IT, sigurinë kibernetike, shkëmbimet kulturore dhe programet arsimore. Megjithëse mosmarrëveshjet dypalëshe, që ekzistojnë prej një kohë të gjatë nuk do të zhduken brenda natës, të paktën çdo shoqëri duhet të bëhet e vetëdijshme kur një palë e tretë grabitqare, synon t'i shfrytëzojë ato në funksion të avantazhit të vet.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 24 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktorë: **Shkëlzen HALIMI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Koha për Sport

Koha, e hënë 25 dhjetor, 2017

Shaqiri i pesti

Tre lojtarë të Mançester Siti janë aktualisht asistuesit më të mirë në Premier ligë, kurse Shaqiri ndan pozitën e pestë me nëntë lojtarë. De Bryne, Sane dhe Silva – janë asistuesit më të mirë në Premier ligë në sezonin 2017/18, me nga tetë asistime. Top pesëshja kompletohet me Ramsej të Arsenalit (6) dhe Azpilikueta i Çellsit (5). Xherdan Shaqiri ndan pozitën e pestë me nëntë lojtarë. Shqiptari deri më tani ka dhuruar pesë asistime.

LAJME SHKURT

Sampdoria e Benevento pas Qakës

Media italiane "Liguria24.it" ka përmendur emrin e Kamer Qakës, si një lojtar që ka tërhequr vëmendjen e dy ekipeve italiane që luajnë në Seria A. Sipas asaj që shkruan kjo media, për Qakën interesohen ekipet e Sampdorias dhe të Beneventos, por edhe të ekipit rumun Kraiova. Gjithashtu e kanë përshkruar mesfushorin si norvegjez, por i natyralizuar si shqiptar, për shkak të vendit të origjinës. Ndërsa në titull kanë përdorur edhe krahasimin me Kakan, për shkak të ngjashmërisë në emër.

Memushaj pëlqehet nga klube të tjera italiane

Benevento ka grumbulluar vetëm 1 pikë në 18 ndeshje në Serinë A italiane, dhe forma e tyre është për faqe të zezë. Por, për Ledian Memushaj, ka ekipe të tjera, që po e kërkojnë seriozisht. Nga Italia, bëjnë me dije se mesfushori shqiptar pëlqehet nga Kievo, në Serinë A, por edhe nga një klub tjetër, që militon në ligën e dytë, ai i Frosinones. Futbollisti nga Vlora, pritet që në janar të kalojë në një ekip tjetër.

LFK TETOVË SHPËRBLEN MË TË MIRËT PËR VITIN 2017

Shkëndija ka dominua me çmime në manifestimin e LFK-Tetovë për më të mirët e vitit 2017. Hasani u shpall "Futbollisti i vitit", Ibraimi golashënuesi më i mirë, çmimi "Trajneri i vitit" i takoi Bekim Osmanit, ndërsa mirënjohje të veçanta morën Bejtullai dhe Murati

DOMINON SHKËNDIJA

Shkup, 24 dhjetor - Në organizim të Lidhjes Futbollistike Komunale të Tetovës, u mbajt manifestimi sportiv ku u shpallën më të mirët e futbollit tetovar për vitin 2017. Të pranishëm në këtë manifestim kulturo-sportiv ishin kryetarët e komunave të Tetovës, Bërvenicës dhe Bogovinës, përfaqësues të FFM-s dhe emra të njohur të futbollit nga rajoni i Pollogut. Ndryshe, KF Shkëndija ka dominuar me çmime në këtë manifestimin. Kapiteni i saj Ferhan Hasani është shpallur "Futbollisti i vitit", ndërsa Besart Ibraimi me 31 gola brenda vitit 2017, i takoi çmimi i golashënuesit më të mirë, derisa çmimi "Trajneri i vitit" i takoi Bekim Osmanit falë ecurisë së shkëlqyeshme me KF Shkëndija U-19, ndërsa mirënjohje të veçanta për "Prezantim të denjë në EURO 2017 për futbollistë U21" u nderuan Egzon Bejtullai dhe Mevlan Murati. Ndërkohë, nderi futbolliste e vitit i takoi Arita Lokit . Me plaket të veçantë organizatori nderoi veteranët e futbollit Haqim Memetin, Nexhbedin Sinanin, Abdurezak Rustemin-Doda,Harun Isa, Ibraim Osmani, Skender Jonuzi, Shaban Elezin dhe disa të tjerë. Tre arbitrat e dalluar të vitit që e lëmë pas janë Habil Livoreka, Furkan Idrizi, dhe Darko Jovçevski. Organizatori ndau edhe mirënjohje edhe për disa kontribuues të futbollit i Mujdin Ismaili e Faton Zylbehari. NPK Tetova iu nda plaket për përkrahjen e sportit në rajonin e Tetovës. Manifestimin e madhëruan edhe anëtarët e SHKA "Xheladin Zeqiri" dhe nxënësit e shkollës së mesme të muzikës të cilët interpretuan disa pika muzikore që mahnitën të pranishmit.

Xhaka i lumtur për golin e parë

Arsenali dhe Liverpuli kanë zhvilluar një ndeshje të jashtëzakonshme mbrëmjen e së premtes teksa barazuan 3-3. Golin e dytë në këtë sfidë për Arsenalin e realizoi mesfushori shqiptar Granit Xhaka me një gjuajtje fantastike nga distanca. Xhaka ka postuar një foto në profilin e tij zyrtar në "Instagram" ku ka folur edhe rreth ndeshjes. "Nuk ishte rezultati që dëshiruam por megjithatë duhet të kemi një karakter të madh të kthehemi nga dy gola disavantazh", ka shkruar Xhaka. Goli ndaj Liverpulit ishte i pari këtë edicion për Xhakën me fanellën e Arsenalit në Premier Ligë.

Mehmedi afër largimit nga Leverkuseni

Sulmuesi shqiptar nga Gostivari, Admir Mehmedi mund të largohet nga Bajer Leverkuseni në afatin kalimtar të janarit, raportojnë mediat gjermane. "Bild" e "Sky Sport.de" raportojnë se Mehmedi po kërkohet me ngulm nga Hamburgeri, që e kishte e kërkuar edhe në afatin kalimtar të verës në huazim, por që një gjë e tillë nuk ishte realizuar. Sipas këtyre raportimeve thuhet se Leverkuseni pritet të pranojë ofertën e Hamburgerit për Mehmedin, që në këtë sezon po lufton për mbijetesë. Në rast se realizohet ky transferim, atëherë Mehmedi te skuadra e Hamburgerit do të gjejë futbollistin e Kombëtares së Shqipërisë, Mërgim Mavraj.

SEFERI E PËRFUNDON VITIN ME FITORE

Shkup, 24 dhjetor - Boksieri i njohur shqiptar, Nuri Seferi, ka fituar një meç shumë të rëndësishëm në fund të vitit 2017. Ai mbylli me fitore vitin 2017, duke e mposhtur gjeorgjianin Gogita Gorgiladzen. Seferi ka fituar pas tetë rundesh, në të cilat dominoi plotësisht. Meçi u mbajt në Hamburg të Gjermanisë, ku Seferi kishte përkrahje si gjithmonë nga shqiptarët dhe i gëzoi ata me një fitore mjaft të rëndësishme. "Fitore bindëse mbas 8 rundeve dominim. URIME të gjithë Shqiptareve", thotë boksieri shqiptar i peshave të rënda, Nuri Seferi. Ky ishte meçi i fundit për këtë vit për boksierin kuqezi, i cili nuk dorëzohet asnjëherë.



BESIR ALILI, MUNDËS I KM "LIRIA"

"DJALOSHI I ARTË" DHE SHPRESA E MUNDJES SË MAQEDONISË

"Vetë sporti i mundjes që është një sport luftarak më shtyri që të merrem me këtë sport, por prapë se prapë 'fajtori' kryesor është babai im, i cili ka qenë një sportist, por jo mundës por boksier. Mua më bëri përshtypje mundja, pasi që i ndjeri profesori Mantaz Allajbegu ishte shok i babit dhe ai vazhdimisht i fliste atij për mundjen, ndërsa dëshira që të merrem me mundje ishte prezent edhe tek unë", thotë 14-vjeçari nga Vizbegu i Shkupit

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 24 dhjetor - E quajnë "djaloshi i artë", pasi edhe pse i ri në moshë, deri më tani ka fituar shumë medalje të arit. E pëlqen Abdullsallam Gadisovin dhe dëshiron të bëhet si ai. Fjala është për Besir Alilin, mundësin e KM "Liria", i cili është e ardhmja e mundjes së Maqedonisë. Për gazetën KOHA, Alili rrëfen hapat e parë në sportin e mundjes, sukseset e tij të deritanishme dhe dëshirën e madhe. "Hapat e parë me mundjen i kam filluar te Klubi i Mundjes 'Liria' edhe atë nën drejtimin e trajnerit Sufijan Ismaili, i cili ka qenë trajneri im i parë. Vetë sporti i mundjes që është një sport luftarak më shtyri që të merrem me me këtë sport, por prapë se prapë 'fajtori' kryesor është babai im, i cili ka qenë një sportist, por jo mundës por boksier. Mua më bëri përshtypje mundja, pasi që i ndjeri profesori Mantaz Allajbegu ishte shok i babit dhe ai vazhdimisht i fliste atij për mundjen, ndërsa dëshira që të merrem me mundje ishte prezent edhe tek unë dhe ja që kjo dëshirë u realizua dhe sot e kësaj dite po merrem me këtë sport", filloi rrëfimin e tij për gazetën KOHA, Alili.

NË MAQEDONI S'KA KONKURRENCË

Talenti i Besirit ka dal në shesh shumë shpejtë. Në garat shkollore për fëmijë ai ka fituar medaljen e parë. Ndërsa sot e kësaj dite ai në Maqedoni është thjeshtë pa konkurrencë. "Medalja ime e parë e ka qenë në garat shkollore për fëmijë dhe pastaj kam filluar të marr pjesë në shumë turnirë të ndryshme vendore por edhe ndërkombëtare. Kuptohet nuk kanë munguar sukseset, pasi kam arritur të ngadhënjej në turnirë të fuqishëm duke u shpall kampion absolut ndaj mundësve të shteteve të ndryshme si Turqisë, Bullgarisë, Moldavisë, Rusisë dhe Gjeorgjisë. Sa i përket konkurrencës në Maqedoni, me punën e pandalshme te Sufijan Ismailit dhe trajnerëve tjerë, nuk kam konkurrencë dhe jam i pamposhtur", shtoi më tej shpresa e mundjes së Maqedonisë.

KAMPION BALLKANIK, SUKSESI MË I MADH

Në Maqedoni thamë se nuk ka konkurrencë, derisa fuqinë e tij 14-vjeçari e dëshmoi edhe jashtë saj, pasi në vitin 2016 u shpall Kampion i Ballkanit në Bursa të Turqisë, ndërsa këtë vit u bë i treti i Ballkanit në "Murska Subota". "Vitin e kaluar u shpalla Kampion i Ballkanit, eveniment ky i cili u mbajt në Bursa të Turqisë. Aty arrita që në kategorinë deri 32 kg në finale të mposht mundësin vendas Mikail Alkan me rezultatin 11:4. Ndërkohë, këtë vit nuk arrita të mbroj titullin, pasi arrita të fitojë vendin e tretë. Arsyeja se pse nuk arrita të përsëris suksesin e vitit të kaluar ishte lëndimi. Shpresojë se me ndihmën e Zotit viti që vjen të përgatitem sa më mirë dhe përsëri të shkëlqej në kampionatin e ardhshëm ballkanik, por jo vetëm aty por edhe kampionatet evropiane dhe botërore. Trajneri Ismaili ka përgatitur një plan-program shumë të mirë për vitin e ardhshëm dhe besojmë se nuk do të na mungojnë medaljet".

SYNIMI KRYESOR LOJËRAT OLIMPIKE

Për 14-vjeçarin nga lagja Vizbeg e Shkupit synimi kryesor nuk do të jetë vetëm Kampionati Ballkanik, Evropian apo Botëror. E themi këtë pasi "djaloshin e artë" që tani ka filluar të përgatitet edhe për Lojërat Olimpike në Buenos Aires, pasi ai konsiderohet njëri prej kandidatëve më serioz për të marr pjesë në këtë eveniment. "Me Zotin para besoj se do të arrij të kap normën olimpike për të marr pjesë në Lojërat Olimpike për fëmijë në Buenos Aires, të cilat do të mbahet vitin e ardhshëm. Ne veç më kemi filluar të përgatitemi për këto LO, ndërsa besoj se do t'ia arrijmë qëllimit", përfundoi Besir Alili.

Erjona Sulejmani, bashkëshortja e futbollistit shqiptar të kombëtares së Zvicrës, Blerim Xhemailit, me të cilin ka nisur tashmë një proces divorci, e përcakton veten më inteligjente në mesin e "Wags", edhe pse publiku e kishte njohur për shumë talente të tjera. Cekim, çifti ka një djalë, i cili quhet Luan

ISH-GRUAJA XHEMAILIT PRANON HOMOSEKSUALITETIN NË FUTBOLL

Gjatë Kampionatit Evropian të Futbollit 2016 ra në sy modelja me origjinë shqiptare. Në fakt spikati për gjërat e ekspozuara në "stenda" dhe të kapura menjëherë nga fotografët. Në një intervistë për "metropoli.al", ish gruaja e futbollistit nga Bogovina e Tetovës, flet edhe për jetën e saj dhe bashkëshorten e Mauro Ikardit, Vanda Nara si dhe tregon se a do të martohet përsëri me një futbollist apo jo.

- Cila është karakteristika që ju dallon nga "capitane" e tjera?

Secili prej 'capitane' ka personalitetin e vet. Madje, është personaliteti im i fortë, që më dallon.

- Ju e përkufizoni veten si më të zgjuarën e "Wags": kur keni marrë dëshmi për këtë?

Unë e quaj veten më inteligjente, sepse kam pasur forcën për të zgjedhur rrugën time dhe të heq dorë nga bota e artë, me ndërgjegjësimin se lumturia nuk rrjedh nga e mira ekonomike. Aspekti që e gjej të vështirë për t'u kuptuar në botën e femrave është pikërisht ajo e pranimit të gjithçka, ose pothuajse gjithçka, për të qëndruar në botën e "zanave".

- "Lojtarët e futbollit nuk janë amatorë të mëdhenj. Ata zgjedhin të bëjnë atë që duan vetë", thatë ju. A do të donit të shpërndanit një mit?

Asnjë mit për t'u demaskuar! Ky është thjesht realiteti i sotëm!

- Por, a është e vërtetë se homoseksualiteti është një tabu në botën e futbollit?

Për fat të keq, homoseksualiteti është një tabu në përgjithësi dhe jo vetëm në futboll.

- Xhemaili u ankua se ju donit të përdornin emrin e tij për punën tuaj.

Nuk pendohem që u bëra 'capitane'. Në të vërtetë, do ta bëja sërish, sepse kisha konfirmim nga njerëzit që më ndjekin dhe që e kanë vlerësuar edhe më shumë personin dhe personalitetin tim. Kështu që falënderoj autorin Gabriele Parpiglia për këtë mundësi. Mbiemri i burrit tim? Para së gjithash u prezantova në publik si Erjona Sulejmani, por si grua e martuar unë kam të drejtën të përdor edhe Xhemaili.



- Rreth "Wags": Çfarë mendoni për Vanda Nara dhe rolin e saj të dyfishtë, si grua dhe menaxhere e Mauro Ikardit?

Unë e respektoj. Ajo e bën shumë mirë këtë rol dhe shërben si një shembull për të gjitha "Wags" e tjera, sepse tregon se pas një profesionisti të madh ekziston gjithmonë një grua e madhe.

- Të martohesh me një futbollist, a do ta bësh përsëri?

Kurrë mos thuaj kurrë në jetë. Por kam mësuar rrugën e vështirë, që kur një vendim të djeg një herë, atëherë ju e keni thuajse të pamundur të riktheheni përsëri.

Nuk pendohem që u bëra 'capitane'. Në të vërtetë, do ta bëja sërish, sepse kisha konfirmim nga njerëzit që më ndjekin dhe që e kanë vlerësuar edhe më shumë personin dhe personalitetin tim. Kështu që falënderoj autorin Gabriele Parpiglia për këtë mundësi. Mbiemri i burrit tim? Para së gjithash u prezantova në publik si Erjona Sulejmani, por si grua e martuar unë kam të drejtën të përdor edhe Xhemaili.

TIFOZËT NË KRAH TË GATTUSOS

Në fund të ndeshjes, tifozët "ultras" i janë drejtuar trajnerit Xhennaro Gattuso, duke i kërkuar atij të përdorë mënyrat e forta. "Gattuso, merri me shkelma b.." ka qenë kori i tifozëve, duke kujtuar që trajneri kuqezi ka qenë një ish-lojtar i rëndësishëm i Milanit vite më parë, që karakterizohej nga shpirti luftarak dhe temperamenti i lartë në fushë, gjë që nuk duket te skuadra e sotme

I KËRKOJNË TË PËRDOR MËNYRAT E FORTA

Edhe tifozët e Milanit kanë mbetur të zhgënjyer nga paraqitjet e deritanishme të skuadrës kuqezi në kampionat, që të shtunën u mund 2-0 në "San Siro" nga Atalanta, duke zhgënjyer shumë me lojën e treguar në fushë. Vërshëllimat në fund të ndeshjes në adresë të skuadrës kanë qenë të shumta, kryesisht për lojtarët, që nuk po luajnë me zemër. Në fund të ndeshjes, tifozët "ultras" i janë drejtuar trajnerit Xhennaro Gattuso, duke i kërkuar atij të përdorë mënyrat e forta. "Gattuso, merri me shkelma b.." ka qenë kori i tifozëve, duke kujtuar që trajneri kuqezi ka qenë një ish-lojtar i rëndësishëm i Milanit vite më parë, që karakterizohej nga shpirti luftarak dhe temperamenti i lartë në fushë, gjë që nuk duket te skuadra e sotme. "Nderoni fanellën që po vishni", "Do të zgjoheni apo jo", kanë qenë disa nga koret e lëshuara nga tifozët pas ndeshjes, që për momentin kanë në shënjestër vetëm lojtarët dhe jo trajnerin, që mbetet një ikonë e klubit kuqezi. Ata i kërkojnë trajnerit që të përdorë metodat e forta për të karikuar skuadrën, por duket se edhe ndryshimi në stol, duke larguar Montellën dhe sjellë Gattuso, nuk ka dhënë rezultatin e shpresuar, duke lënë të kuptosh se nuk është faji i trajnerit por i skuadrës. Në 4 ndeshje që ka qenë në krye të skuadrës në kampionat, Gattuso ka marrë vetëm 4 pikë. Në anën tjetër, Gattuso ishte ai që mori përgjegjësitë e humbjes, duke theksuar se zgjedhjet në fushë I kishte bërë ai dhe i pandikuar. "Zgjedhjen i bëj unë dhe rrjedhimisht marr edhe përgjegjësinë e kësaj humbjeje të papranueshme. Jemi në një moment të vështirë dhe na duhet shumë punë të dalim nga kjo situatë dreqi. Nuk e mendoj largimin, pasi unë jam problem i fundit te ky Milan", deklaroi trajneri i Milanit.

REVOLUCION TE REALI



Benzema në shitje pas humbjes në "El Clasico"

Humbja në "El Clasico" ka lënë pasoja të skuadra e Real Madridit, që ka ndërmend të bëjë një revolucion dhe i pari që do të preket është sulmuesi francez Karim Benzema. E përditshmja spanjolle "Don Balon" bën me dije se para ndeshjes të humbur ndaj Barcelonës (Real u mund në "Santiago Bernabeu", 0-3) presidenti Florentino Perez i ka kërkuar sulmuesit francez që të luajë mirë, në të kundërt do të largohet nga skuadra menjëherë pas këtij takimi. Dhe humbja 0-3 në fushën e tij i ka kushtuar rëndë jo vetëm Realit, që ndodhet -14 pikë nga Barcelona por edhe sulmuesit francez, që duket se do të jetë i sakrifikuari i parë. Benzema pritet të largohet në merkaton e janarit që nis pas një jave, ndërkohë që Perez është në kërkim të një zëvendësuesi të denjë. Në shënjestër është sulmuesi argjentinas i Interit, Mauro Ikardi, për të cilin përflitet prej kohësh se do të shkojë në Madrid për të luajtur me "merengues".

Barça fitoi "Klasiken", Vidal tallet me Ronaldon

Barcelona mposhti Realin me rezultatin 3-0 në "El Clasico" dhe Aleks Vidal me nuk mund të priste dot të tallej me Kristiano Ronaldon, menjëherë pas vërshëllimës së fundit. Katalanasit vendosën diktatin në "Santiago Bernabeu", duke hipotekuar që tani rrugën drejt titullit kampion, me plot 14 pikë epërsi ndaj "Los Blancos". Ishin pikërisht tre golat e realizuar në pjesën e dytë të përballjes nga Luis Suarez, Lionel Messi dhe Aleks Vidal ata që groposën përfundimisht madrilenët. Mbrojtësi i djathtë i ekipit blaugrana nuk mundi dot t'i rezistojë tundimit për të tallur Ronaldon dhe menjëherë pas përfundimit të ndeshjes, në festimin e skuadrës katalanase në dhomat e zhveshjes, u fotografua duke imituar qëndrimin e legjendës së Real Madrid. Andres Iniesta dhe Suarez që të dy kanë publikuar foton e skuadrës duke shijuar fitoren, aty ku Vidal shfaqet me krahët e hapur, pikërisht në pozën e tradicionale festimit të golave nga KR7. "Mënyra më e mirë për të mbyllur vitin! Forca Barça", ishin fjalët me të cilat Iniesta shoqëronte foton.

Publicitet

Shpallja e publikuar më datë 23.12.2017 në gazetën "Koha", nën pikën 16 ndryshon dhe do të jetë si në vijim:
" 16. Mësimdhënës të mësimit praktik – 1 realizues 27 orë praktike, me neto pagesë bazë prej 20.446,00 denarë."

SHMNG e QSH Zdravko Cvetkovski
Drejtor
Dragica Kostadinova

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, nenit 74 të Statutit të SHFK "Krste P. Misirkov" Radovish ndërsa në pajtim me nenin 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor si dhe Vendimit për publikim të shpalljes, U. D Drejtori i shkollës publikon

SHPALLJE
Për plotësimin e vendeve të punës në vijim:

1. Një mësimdhënës të biologjisë, me orar të plotë të punës për kohë të caktuar, pagesa prej 19.917,00 denarë;
2. Një mësimdhënës të mësimit klasor, me orar të plotë të punës, zëvendësim të drejtorit, pagesa prej 19.917,00 denarë;
3. Një mësimdhënës të gjuhës gjermane, me 12 orë mësimore në javë, pagesa prej 12.000,00 denarë;
4. Një mësimdhënës të BAT, me 8 orë mësimore në javë, për mësimin në gjuhën turke, pagesa prej 7.970,00 denarë;
5. Një mësimdhënës të shkencave natyrore me 4 orë mësimore në javë, për mësimin në gjuhën turke, pagesa prej 3.985,00 denarë;
6. Një mësimdhënës të matematikës dhe fizikës, për mësimin në gjuhën turke, me orar të plotë të punës, pagesa prej 19.917 denarë;
7. Një mësimdhënës të etikës, me 7 orë mësimore në javë, pagesa prej 6.972,00 denarë;
8. Një mësimdhënës të etikës së religjioneve për mësimin në gjuhën maqedonase me 6 orë mësimore në javë, pagesa prej 5.990,00 denarë;
9. Një mësimdhënës të etikës së religjioneve për mësimin në gjuhën turke, me 6 orë mësimore në javë, pagesa prej 5.990,00 denarë;
10. Tre mësimdhënës të mësimit klasor për mësimin në gjuhën turke, me orar të plotë të punës, pagesa prej 19.917,00 denarë;
11. Një mësimdhënës të artit figurativ, me 6 orë mësimore në javë, pagesa prej 5.990,00 denarë;
12. Një mësimdhënës të edukatës fizike dhe shëndetësore, me 16 orë mësimore në javë, pagesa prej 15.934,00 denarë;

Vendet e punës plotësohen për kohë të caktuar, gjegjësisht deri më 31.08.2018;
Shkolla punon me dy ndërrime edhe atë: ndërrimi i parë prej ora 7,00 deri në ora 13,00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13,00 deri në ora 19,00.
Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me LMP, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e parapara me nenin 77 dhe 80 të Ligjit për arsim fillor.
Përveç fletëparaqitjes kandidatët duhet të parashtrojnë: certifikatë – diplomë për arsimin e mbaruar përkatës, certifikatë të shtetësisë.
Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit dhe të pakompletuara sipas shpalljes, nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.
Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.
Dokumentet e nevojshme parashtrohen në arkivin e shkollës.
Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të shpalljes.

SHFK "Krste P. Misirkov" – Radovish,
U. D Drejtor,
Stojanova Ollgica

Mendo
JETË më të SIGURITË,
më të MIRË
dhe
më të GJATË.

Mendo UNIQA
SIGURIME
JETË dhe JO-JETË

+389 2 3288 800
www.uniqa.mk

SHFUQIZIMI I GJYKATËS SPECIALE, "BUDALLALLËKU" QË DËMTON KOSOVËN

Kuvendi i Kosovës më 3 gusht të vitit 2015 pati miratuar me procedurë të përshpejtuar Ligjin për Gjykatën Speciale. Miratimi ishte bërë me shumicë votash, por pa pjesëmarrjen e partive të opozitës, të cilat atë kohë i bojkotuan punimet e Kuvendit

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka vlerësuar Gjykatën Speciale si "të padrejtë për Kosovën". Ky vlerësim i kryeministrit Haradinaj, vjen pas dy dështimeve të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, ditën e premte, që të sigurojë kuorumin për shqyrtimin e kërkesës së 43 deputetëve nënshkrues, me të cilën kërkohej seancë e jashtëzakonshme për shfuqizimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e prokurorit të specializuar, që njihet si Gjykata Speciale. Në një adresim për zyrtarët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, lider i së cilës është Haradinaj, ai ka thënë se Gjykata Speciale ia rëndon imazhin Kosovës.

"Ideja e deputetëve, kërkesa e deputetëve, për ta shfuqizuar ligjin... unë nuk kam koment. Kjo është e deputetëve. Deputetët janë të zgjedhurit e popullit. Nëse do ta votonin dje, me 61 vota, për mua do të ishte ligj. Edhe çdo herë do të jetë, sepse kur voton Parlamenti, për Qeverinë është ligj", ka thënë Haradinaj. Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, përmes një shkrimi në rrjetin social Facebook, ka thënë se "në vazhdimësi ka pasur qëndrime të ndryshme rreth Gjykatës Speciale", duke theksuar se e premtja nuk ka qenë ditë e lehtë për Kosovën. "Në respektim të Rregullores së Kuvendit, iniciativa e 43 deputetëve për të sjellë një projektligj që shfuqizon Ligjin për Dhomat e Specializuara është shqyrtuar dhe është proceduar për vendimmarrje, bazuar në Rregulloren e Kuvendit. I gjithë procesi është zhvilluar konform ligjeve të vendit dhe qëndrimeve politike të secilit subjekt. Kosova qëndron e palëkundur në përkushtimin e vet perëndimor, për integrim në Bashkimin Evropian dhe për raporte të veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka thënë Veseli. Ai, gjithashtu, ka bërë të ditur se "Kuvendi i Kosovës, në bazë të Rregullores dhe Kushtetutës, nga e shtuna, futet në pushimin dimëror, deri në javën e tretë të muajit janar". Ndryshe, më herët, të shtunën, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, përmes rrjetit social Twitter, ka shkruar se drejtuesit e Kosovës mbeten të angazhuar për demokraci dhe sundim të ligjit. "Mes spekulimeve, është e rëndësishme që të gjithë të vazhdojnë të jenë të sigurt për të ardhmen e Kosovës dhe për proceset e saj demokratike. Shoqëria dhe udhëheqësia e Kosovës mbeten plotësisht të angazhuara për demokraci, sundim të ligjit, pajtim, dialog dhe marrëdhënie në baza të barabarta dhe të drejta", ka shkruar Thaçi në Twitter. Por, i menjëhershëm ka qenë reagimi i Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, lidhur me nismën për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. "Një vendim për revokimin e Gjykatës Speciale do të shënonte një pikë kthese larg sundimit të ligjit, Evropës dhe Shteteve të Bashkuara. Kosovë, mos e zgjidhni atë të ardhme për fëmijët tuaj!", ka shkruar Delawie në Twitter.

Njohësit e çështjeve juridike kushtetuese, thonë se pas dështimit, në ditën e premte, që Kryesia e Kuvendit ta procedojë propozimin për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, procedimin e një projektligji për shfuqizimin e kësaj gjykate, mund ta bëjë Qeveria e Kosovës. Megjithatë, sipas tyre, një tentim i tillë, përsëri do të përballej me procedura, të cilat mund ta stopojnë procedimin e këtij projektligji deri te deputetët e Kuvendit të Kosovës. Mazllum Baraliu, profesor i të Drejtës Kushtetuese, duke folur për Radion Evropa e Lirë, shpjegon se në parim, Qeveria e Kosovës mund ta bëjë projektligjin për shfuqizimin e Gjykatës Speciale dhe ta dërgojë atë në Kuvend. Sipas tij, Kuvendi më pas, do të duhej sërish ta thërriste Kryesinë, për të caktuar rendin e ditës së seancës dhe më pas, me shumicë votash ta dërgojë këtë projektligj në seancë parlamentare. Por, sipas profesor Baraliut, pengesa e parë për t'u proceduar më tutje një projektligj i tillë eventual, do të mund të hasej në Kryesi të Kuvendit. "Pikërisht që mund të ndodhë një situatë çfarë ishte të premten. Pa kuorum të caktuar në Kryesi të Kuvendit, nuk mund të caktohet rendi i ditës, rendi i punës së asnjë seance, çfarëdo qoftë ajo, parlamentare e rregullt apo e jashtëzakonshme, siç ishte tentuar të mbahej dje", thotë ai. Profesor Baraliu shton se edhe në rast se projektligji eventual për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, në cilëndo mënyrë do të arrinte në rend dite në Kuvend, vështirë se do të mund të kalonte, për shkak të procedurave të mëtejme. Sipas tij, një projektligj i tillë nuk do të mund të votohej për të kaluar me shumicë të thjeshtë. "Meqë kemi të bëjmë tashmë me nivelin kushtetues - sepse nuk ka pasur bazë kushtetuese që të bëhej Ligji për Gjykatën Speciale dhe është dashur të ndryshohet Kushtetuta e pastaj të miratohet ligji - tash është procedura e njëjtë, me miratim dhe shfuqizim të ligjeve. Do të duhej edhe në këtë rast që të ndryshohet fillimisht Kushtetuta, e pastaj të votohej ligji, eventualisht me shumicë të thjeshtë, mirëpo, kështu siç është situata. Ky ligj, duhet domosdo t'i ketë dy të tretat e Kuvendit, përndryshe nuk mund të procedohet më tutje edhe po të shkonte eventualisht nga Kryesia në seancën përkatëse plenare të Kuvendit", shpjegon Baraliu. *(REL)*



18 vjet burg për priftin pedofil që dikur u strehua në Kosovë

Një prift katolik që kishte abuzuar me djem në një shkollë në Londër në vitet e '70-ta dhe '80-ta, është dënuar me burgim prej 18 vjetësh. Laurence Soper, 74 vjeç, kishte ikur në Kosovë me 182,000 funte nga banka e Vatikanit në tentim që t'i shmangej ndjekjes penale për abuzimet që kishte bërë me djem në shkollën e pavarur St Benedict, në Ealing, ku edhe ligjëronte, raporton "Kaplanherald". Ai u ekstradua për t'u përballur me 19 akuza për sulme të pahijshme dhe serioze seksuale ndaj 10 ish nxënësve, transmeton Koha.net. Soper është burri i katërt që dënohet për ngacmime seksuale ndaj fëmijëve në shkollën në fjalë. Gjatë shpalljes së vendimit, gjykatës Anthony Bate tha se veprimi i Soperit ishte "shkelja më e tmerrshme e besimit" dhe ai "ka përmbysur rregullat e rendit benediktian dhe të mësimeve të Kishës Katolike". Ai tha se jeta e ish-abatit dhe drejtorit tani do të "mbesin nën hije nga katalogu i dëshmuar i abuzuesve të turpshëm".

Djali vret babain dhe e hedh në liqen

Një vrasje tronditëse u zbardh nga Policia e Tiranës mëngjesin e së dielës. Selman Alija, 28 vjeç, dyshohet se ka vrarë të atin në oborrin e shtëpisë së tyre në zonën e Shkozës. Më pas, e ka futur trupin e pajetë të babait të tij në makinën e familjes dhe e ka hedhur në Liqenin e Farkës, ku sot në mëngjes u gjet nga policia. Mbrëmjen e së premtes, 28-vjeçari e ka qëlluar të atin 74-vjeçar me çekiç disa herë në pjesën e kokës, duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme.

Shënimi i vijës me Malin e Zi, në janar

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj deklaroi se çështja e demarkacionit me Malin e Zi, e kthyer në një ngërç për vendin, do të marrë zgjidhje në janar. Muajin e ardhshëm, - u shpreh Limaj, - ne do të dërgojmë në Kuvend një variant të paktit të pranueshëm për të gjithë. "Demarkacioni do të përmbyllet. Unë pres që muajin e ardhshëm të shkojmë dhe ta kemi shumicën në Parlamentin e Kosovës për të përmbyllur këtë çështje. Demarkacioni do të jetë një variant, i cili do të respektojë interesat e Kosovës dhe të Malit të Zi. Ne po punojmë që kur të shkojmë në Parlament, të gjithë të duartrokasin variantin që do të dërgojmë. Do të duartrokitet nga qytetarët e Kosovës, por edhe nga miqtë tanë. E përfundimisht ta mbyllim këtë temë", tha Limaj. Ne po punojmë në këtë drejtim, duke i respektuar interesat e të dyja vendeve, me qëllimin që nga ky proces askush të mos dalë i humbur, shtoi më tej numri dy i ekzekutivit kosovar. Për mbylljen e çështjes së demarkacionit këmbëngulin si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu edhe Bashkimi Europian, i cili e ka artikuluar qartë në më shumë se një rast, që ky vazhdon të mbetet kushti kryesor për liberalizimin e vizave. Kundërshtarët e ujdisë këmbëngulin se ajo është e padrejtë, pasi i merr Kosovës mbi 8.200 hektarë tokë.

REFUGJATËT E HARRUAR TË LESBOSIT

Ishulli Lesbos një hotspot për refugjatët, ku jetojnë rreth 3000 syresh. Ata nuk mund të lëvizin askund tjetër dhe jetojnë në kushte katastrofike. Situata precipiton nga dita në ditë. Banorëve po u humbet durimi

Strehimorja Moria aty pranë i ngjan një zone të sigurisë së lartë - e krijuar për qëndrimin e refugjatëve në ishull derisa të shqyrtohet kërkesa e tyre për azil. Këtu ndalohet rreptësishtë xhirimi me kamera. Po ashtu ndalohet edhe hyrja për gazetarët

Irakiani Ahmed al Majeed për të pirë një çaj të ngrohtë në mëngjes pas një natë të ftohtë në ishull, i duhet të ndezë një copë karton, sepse prej kohësh ai dhe shokët e tij nuk kanë më asnjë copë dru për zjarr. Që prej dy muajsh irakiani Ahmed al Majeed ka mbetur i bllokuar në një strehimore të improvizuar pranë strehimores zyrtare të refugjatëve Moria. "Ne nuk kemi energji elektrike, as banjë. Po ashtu ne nuk kemi as ujë për t'u larë apo për të larë rrobat. Shumë refugjatë janë të sëmurë, por ne nuk na jepet ndihmë mjekësore, vetëm në raste emergjence". Strehimorja Moria aty pranë i ngjan një zone të sigurisë së lartë - e krijuar për qëndrimin e refugjatëve në ishull derisa të shqyrtohet kërkesa e tyre për azil. Këtu ndalohet rreptësishtë xhirimi me kamera. Po ashtu ndalohet edhe hyrja për gazetarët.

KUSHTE TË MJERUESHME JETESE

Ahmed al Majeed na tregon se çfarë ndodh brenda strehimores. Anë e mbanë vjen erë tym, mbeturinash dhe fekalesh. Sekretariati i OKB-së për refugjatët, UNHCR, e ka cilësuar së fundi të rrezikshme strehimoren Moria për gratë dhe fëmijët - e pikërisht atyre u duhet të qëndrojnë të ngujuar këtu. Shumë prej tyre ndodhen me muaj në strehimore. "Ne nuk na japin dokumente për t'u larguar nga strehimorja. Policia nuk kujdeset për sigurinë tonë. Është lagështirë dhe ne nuk kemi energji", thotë al Majeed. Për t'u ngrohur secili përpiqet të gjejë mënyrën e vet, sepse po bëhet gjithnjë e më ftohtë. Disa djegin pemët e ullinjve, për të bërë zjarr. Por ata kanë dëmtuar ulishtat e pronarëve si Stelios Kathiotis. Kur ai vjen te ullishtat e tij indinjohet e mezi e mbledh mendjen. Në këtë ullishtë ai ka investuar gjithë jetën e tij, por tashmë nuk ka mbetur shumë gjë prej saj. Me breza në familjen e tij kanë kultivuar ullinj. Disa pemë janë deri në 300 vjeçare. "Të gjitha këto pemë janë djegur. Nuk ka mbetur më asgjë prej tyre. Ato nuk do të rriten më, janë shkatërruar tërësisht. Këtu dikur ka pasur 120 pemë ulliri. Tani kanë mbetur vetëm katër. Askush nuk na zhdëmton ne, apo as nuk kujdeset për t'i ndaluar refugjatët", thotë Stelios Kathiotis. Kathiotis tregon se si refugjatët hyjnë e dalin në ullishtë përmes një të çare në gardh. Të gjitha përpjekjet për t'i denoncuar refugjatët në polici kanë qenë pa sukses. Madje edhe për këtë arsye refugjatët i janë vërsulur tani edhe bagëtisë së tij. Ata që kanë qenë së fundi kanë lënë këtu madje edhe veglat me të cilat kanë shkaktuar dëmin, thotë bujku.

Këtë ai tani e tregon si një trofe. Një çantë shpine e sekretariatit të OKB-së për refugjatët dhe një thikë - për të një dëshmi e qartë, se këtu kanë qenë refugjatët. Përse refugjatët i therin delet e tij, për këtë bujku ka një teori të vetën. "Ato nuk e vjedhin bagëtinë, prej urisë. Por ata i therin delet për t'i shitur ato më tej. Një apo dy vetë nuk mund të hanë shtatë apo dhjetë dele. Ne i kemi parë vet. Ata ua kanë shitur ato refugjatëve të tjerë. E pastaj ato i pjekin në hell delet këtu tek ullishtet tona", shprehet Kathiotis.

Fshati Moria ndodhet në gjendje alarmi - Stelios Kathiotis dhe banorët e tjerë takohen rregullisht këtu për të gjetur rrugëdalje nga kriza. Kryetari i fshatit Nikos Trakellis sapo është kthyer nga Athina dhe njofton për bisedimet që ka pasur atje me qeverinë greke - ai nuk mund t'u japë shumë shpresa njerëzve këtu. "Nëse situata mbetet kështu siç është tani dikur do të ketë dhunë mes refugjatëve dhe vendasve. Deri tani ne i kemi toleruar plaçkitjet dhe për fat gjendja deri më sot ka qenë paqësore. Por është vetëm çështje kohe, derisa kjo të ndryshojë".

SHPRESA HUMBET E FUNDIT

Ahmed al Majeed është arratisur nga vendi i tij prej dhunës. Ai nuk do të vihet në një kandar me ata që nuk i respektojnë ligjet. Ai do që të largohet nga ishulli Lesbos. Por një biletë për në Athinë është për të tani një ëndërr e largët. "Unë tani po pres të shqyrtohet kërkesa ime për azil. Por refugjatë të tjerë presin qysh prej tetë muajsh. Ata nuk na lejojnë ne të udhëtojmë më tej. Kështu disa mendojnë të arratisen nga Lesbos", shprehet al Majeed. Ai ende e bluan në mendje arratinë, ndërsa të tjerët kanë një plan konkret. Çdo mbrëmje ata përpiqen pa rënë në sy që kalojnë gardhin për të hipur në traget. Rrugëdalja e fundit nga ishulli, i cili u duket tani atyre si burg.

Edhe zyrtarisht Sobchak "kundër" Putinit

Partia e Nismës Civile në Rusi zyrtarisht e ka nominuar gazetaren dhe personalitetin televiziv, Ksenia Sobchak, për kandidate në zgjedhjet presidenciale, që mbahen vitin e ardhshëm, e në të cilat gjerësisht pritet fitore e presidentit aktual, Vladimir Putin, edhe për një mandat tjetër gjashtëvjeçar. Ky vendim i sotëm i kongresit të kësaj partie, u bë pas deklaratës së gazetares Sobchak, që është e bija e Anatoly Sobchakut, prefekt reformist i qytetit Shën Petersburg në fillim të viteve të 90-ta, dhe mentor i zotit Putin, se ajo synon të nominohet për të qenë kandidate në zgjedhjet presidenciale, që mbahen m 18 mars të vitit të ardhshëm. Sobchak, 36 vjeçare, që ndonjëherë cilësohet si Paris Hilton e Rusisë, për paraqitjet e saj në emisionet reale televizive, që janë konsideruar si tejet kundërthënëse, është shprehur se dëshiron që sistemin politik të vendit të saj ta bëjë më të hapur dhe demokratik. Ajo i kishte zemëruar disa mbështetës të Kremlinit duke thënë se Krimeja është juridikisht pjesë e Ukrainës, megjithqë është aneksuar nga Rusia.

Mijëra demonstrues kërkuan dorëheqjen e Netanyahut

Mijëra izraelitë kanë marshuar nëpër rrugët e Tel-Avivit duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit, Benjamin Netanyahu, për shkak të akuzave për korrupsion. Këto akuza zoti Netanyahu i ka hedhur poshtë. Policia izraelite ka njoftuar mbrëmë se disa mijëra njerëz në qendër të Tel-Avivit, kanë protestuar kundër qeverisë, duke mbajtur mbishkrime për dorëheqje të "ministrit të krimit" dhe të anëtarëve të tjerë "të korruptuar" të qeverisë Netanyahu, të dyshuar për keqpërdorime. Kohëve të fundit kryeministri Netanyahu e ka kritikuar policinë, duke e akuzuar se ka kryer hetime kundër tij me qëllim që ta përmbys atë nga posti aktual. Netanyahu është marrë në pyetje së paku shtatë herë në kuadër të dy hetimeve për korrupsion të mundshëm, përfshirë akuza për ryshfet, mashtrim dhe shkelje të besimit. Benjamin Netanyahu e ka kundërshtuar çfarëdo keqbërjeje.

Rusi, mbahet gara e babagjyshëve në minus 10 gradë celsius

Dhjetëra anëtarë të klubit dimëror të notit, të veshur si babagjyshë, morën pjesë në garën "Santa Claus" në Novosibirsk, në veri të bregut lindor të Siberisë. Përkundër temperaturave prej minus 10 gradë celsius, anëtarët e klubit të notit të veshur me pantollona të shkurta dhe me kapela të babagjyshit, vrapuan rrugëve të qytetit. Pas përfundimit të garës, ata notuan në pishinën e rrethuar nga bora dhe akulli. Novosibirsk është qyteti i tretë për nga madhësia në Rusi, që ndodhet rreth 3300 kilometra larg nga Moska, qyteti më i madh në Siberi dhe qendra administrative e rajonit të Novosibirskut dhe Qarkut Federal të Rusisë. Qyteti rus me aktivitete të ndryshme përgatitet për festat e krishtlindjeve dhe vitit të ri.

KUSH ËSHTË JAMES MATTIS, NJERIU QË PO PËRMBAN TRUMPIN

Protagonist i një karriere brilante të siguruar në fushën e betejës, Mattis po tenton që të forcojë sigurinë e Shteteve të Bashkuara duke përmbajtur "jostrategjinë e paarsyeshme" të Donald Trump. Përballë kaosit të ardhur nga Shtëpia e Bardhë, një figurë e qëndrueshme mbetet në sfond për të na siguruar. Ajo e Sekretarit të Mbrojtjes, James Mattis

"Mad Dog", me këtë nofkë njihet në Shtetet e Bashkuara Gjenerali i trupës së Marinsave James Mattis, kandidat për postin e përgjegjësit të Forcave të Armatosura gjatë fazave të parë të formimit të stafit të Donald Trump. Duke qenë se kemi asistuar tashmë në 12 muaj qeverisje nga ana e manjatit njujorkez dhe duke vërejtur skemat e sjelljes, ndoshta mund të imagjinohet se Trump ka mbetur i goditur nga nofka e çuditshme e Gjeneralit të vlerësuar: emër që mund të bëjë të mendojë për një vizion prej "fajkoi" të politikës, në sintoni me ato të shefit të ardhshëm. Megjithatë, qysh atëherë, është arritur të kuptohet sesi Mattis, tashmë Sekretar i Mbrojtjes, është goxha tjetër nga sa mund të linte të mendoje nofka e "qenit të tërbuar". Bile, ka mundësi, Mattis po demonstrohet si shtylla kryesore e të gjithë administratës. Por kush është në të vërtetë James Norman Mattis?

JETA SI USHTARAK

I njohur në institutet kërkimore amerikane dhe në mjediset e Mbrojtjes si "murg - luftëtar", Sekretari i Mbrojtjes lindi në fillimin e viteve '50 në një familje të lodhur me ambientet ushtarake (e ëma shërbue në inteligjencë gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa i ati punoi në industritë mbështetëse të Projektit Manhattan (atij të famshmit Projekt Manhattan). Mattis u rrit në Washington State dhe jo në shtetet e Jugut, basene tradicionale të rekrutimit të forcave të armatosura (Texas në radhë të parë). Gjithsesi, ajo që padyshim ndikoi mbi zhvillimin e tij qe rritja në një familje liberal (bile disa theksojnë deri hippie) në të cilën televizori ishte i ndaluar dhe në vend të tij ishin raftet e mbushur plot me libra. Leximi për marinsin e ardhshëm u bë një pasion në kuptimin e vërtetë të fjalës, deri në pikën që dëshmi të ndryshme na përcjellin se në pikun e saj biblioteka personale e Mattis arriti një total prej 7000 vëllimesh: kryesisht tekste që kanë të bëjnë me historinë ushtarake dhe vepra filozofësh. Mattis është një person jashtëzakonisht i kulturuar dhe kjo veçanti e tij mund të ndeshet edhe në mënyrën e tij të të folurit. Gjatë një interviste me redaktorin e një gazete shkollore, tha se "...historia nuk do t'i tregojë të gjitha përgjigjet, por do të çojë që t'i bësh jashtëzakonisht shumë pyetje, duke të ilustruar sesi njerëz të tjerë kanë bërë në të kaluarën pyetje të ngjashme, me ose pa sukses". Disa prej këtyre shprehjeve janë bërë citime në kuptimin e vërtetë të fjalës, aq sa është regjistruar një proliferim në internet i uebsajteve të shumta që përmbajnë shprehjet më të mira të tij - tek Business Insider mund të gjenden disa - dhe deri një hashtag kushtuar atyre: #mattisism Në konfirmim të qasjes intelektuale të tij, rrëfehet sesi gjatë fushatave ushtarake nuk përtonte asnjëherë që të kishte midis objekteve personale Bisedat me vetveten, një prej veprave të Perandorit dhe filozofit Mark Aurel. Gjatë fushatës irakene, në cilësinë e Komandantit të Divizionit të Marinsave - i ngarkuar që të mbulonte sektorin problematic e rajonit sunit iraken të Anbarit (që përfshin Falluxhan dhe Ramadin) - urdhëroi të gjithë njerëzit e tij dhe në mënyrë të veçantë nënoficerët që të lexonin një seri librash të ndodhur në një reading list.

Megjithatë, ky aspekt prej studiuesi nuk duhet të na bëjë të harrojmë karakteristikën e tij me të cilën është i pajisur Gjenerali: agresivitetin. Kjo e fundit pati rast që të shfaqej në shumë raste gjatë shërbimit të tij në Korpusin e Marinsave, në mënyrë të veçantë gjatë viteve të kaluara në tentativën për të zgjidhur kaosin që kishin krijuar vendimet e pamatura e administratës Bush në Irak. Të denjë për t'u përmendur janë padyshim dy episode: i pari që ka të bëjë me fazat e pushtimit, në të cilat Shtetet e Bashkuara u gjenden përpara një rezistence që nuk ishte parashikuar në planifikimin e dobët e fazës pas-operacionale. Pasi ka dislokuar të gjithë armatimin e rëndë (dmth tanket dhe artilerinë), Mattis u dërgoi krerëve të fiseve mesazhin e mëposhtëm: "Kam ardhur në paqe. Nuk kam sjellë artileri. Ama ju lutem, me lot në sy: Nëse tentoni të më mashtroni, do t'ju vras të gjithëve". Kurse episodi i dytë demonstron sesa vetë ky agresivitet mund të drejtohet jo vetëm armikut të mundshëm, por edhe ndaj vartësve të vet. Gjatë marshimit të divizionit drejt Bagdadit, marinsave ju desh që të kalonin një qytet të vogël, të quajtur Kut, i ndodhur gjatë brigjeve të lumit Tigër. Një colonel mori urdhëra në dukje kontradiktorë nga Gjenerali Mattis, Komandant i Divizionit, dhe nga Gjenerali John Kelly, Shef i Shtabit po i këtij divizioni (pikërisht ky John Kelly që është sot Shef i Stafit të Shtëpisë së

Bardhë të Trump). Duke mos kryer urdhërat e marra, oficeri u largua nga komanda gjatë sulmit, një lëvizje që pati shumë jehonë në Shtetet e Bashkuara: janë shumë të rralla rastet ku një oficer largohet nga njësia e tij gjatë luftimeve.

Sa më sipër mund të jetë në dukje pak e qartë, të paktën në motivacionin e saj. Në realitet, Mattis kurrë nuk ju përgjigj pyetjeve lidhur me vendimin e tij, edhe pse indirekt pranoi se në fazat e avancimit drejt kryeqytetit iraken parimi themelor ishte shpejtësia. Kush nuk do kishte marrë mbi vete rreziqe të mëdha boll që ta përmbushte një "mantra" të tillë do të konsiderohej i paaftë që të mbante komandën. Po pse e gjitha kjo? Në thelb prej antipatisë së administratës Bush (me Sekretarin e Mbrojtjes Donald Rumsfeld) ndaj përdorimit të një numri të madh trupash, me nevojën nga ana e forcave të armatosura për të kruer fushatën ushtarake edhe në situate jo optimale. Në fakt është korrekte të kujtohet sesi vetë Gjenerali mbeti i shtangur kur në 2002, teksa luftonte në Afganistan, u thirr në Amerikë për të përgatitur pushtimin iraken.

ROLI NË ADMINI STRATËN TRUMP

Kjo e kaluar ushtarake e përbërë nga zgjedhje kurajoze dhe të vështira padyshim që kontribuoi në drejtimin e mendimit të Mattis, duke e përgatitur me realitetin e ri politik, që gjithsesi demonstrohet shumë shpesh ndryshe dhe ndoshta edhe më kompleks se ai ushtarak. Në mënyrë të veçantë nëse Commander in Chief i yt e ka emrin Donald Trump. Jo rastësisht, në pranverën e kaluar, Sekretari është demonstruar si pika referimit për aleatët e Shteteve të Bashkuara, të tronditur nga deklarimet e improvizuara të Presidentit, shpesh të bëra nëpërmjet Twitter. Mjafton të mendosh për pogimet lidhur me vjetrimin e NATO-s, të thëna pikërisht në momentin ku vendeve evropiane (në mënyrë të veçantë ato që i përkisnin ish bllokut sovjetik) u duhet që të përballojnë kërcënime pakashumë të fshehura të Rusisë. Ose, akoma, afirmimin që Shtetet e Bashkuara duhet të paguhen nga Koreja e Jugut për mbrojtjen e ofruar prej tyre; me efektin anësor e ftesës ndaj kësaj të fundit dhe Japonisë për t'u pajisur me armë bërthamore armë mbi reduktimin e të cilave në nivel global diplomacia është impenjuar prej dekadash. Në të gjithë këto episode, as më të bujshmit, Mattis është impenjuar bashkë me Sekretarin e Shtetit Rex Tillerson (megjithëse ky i fundit në një profil më të ulët) në mbështetje të politikës së jashtme tradicionale amerikane. Për Mattis, në ndryshim nga Trump, kuptimi i konteksteve globale dhe i mekanizmave që i rregullojnë ato është bukë e përditshme, për shkak të përvojave vetjake dhe kulturës së poseduar. Veç kësaj, Mattis është rritur në bindjen strategjike sipas të cilës Shtetet e Bashkuara kanë nevojë për një rrjet aleancash globale të dobishëm që të frenojnë kaosin, në optikën e mbështetjes edhe të ekonomisë së vendit, që bazohet mbi përshkueshmërinë e kufijve, aftësinë për të projektuar fuqinë ushtarake amerikane në çdo kontinent dhe mbi stabilitetin e sistemit ndërkombëtar. Megjithatë aspekti më shumë interesant i mënyrë me të cilën figura e James Mattis është zhvilluar gjatë kësaj periudhe si shef Pentagoni buron jo vetëm nga vizioni strategjik dhe aftësia e tij për ta shprehur me qartësi atë sesa nga imazhi që me dashje dhe/ose padashje ka qenë në gjendje të projektojë mbi publikun në gjerësi. Duhet nënvizuar sesi në të kaluarën ka arritur me sjelljen e tij që ushtarët ta duan dhe ta konsiderojnë si njeriun e tyre (i famshëm episodi në të cilin Gjenerali kaloi natën në një grope në shkretëtirën afganase bashkë me dy tetarë), por një aftësi e tillë shfaqet në mënyrë akoma më madhështore në një administratë që për sa i përket lidershipit ka pak pika referimi. Një artikull i kohëve të fundit i një editorialisti dhe fituesi të Çmimit Pulitzer, Thomas Friedman, në të cilin nxitet - me një farë urgjence - Mattis që të veprojë si digë ndaj ekzagjerimeve të shkaktuara jo vetëm nga mospërvoja e Trump sesa nga vullneti i këtij të fundit për të goditur asetet dhe vlerat e demokracisë aktuale amerikane. Ky rezultat do të ishte i mundur nëpërmjet aftësisë së tij për të ngjallur respekt dhe injektuar sugjestionim: edhe në një njeri të rrahur me vaj e me uthull si Presidenti. Kini parasysh një fakt: Sekretari i Mbrojtjes është një anëtarëve shumë të pakët të administratës apo politikanë në përgjithësi që nuk është sulmuar apo përqeshur ndonjëherë nga Trump. Si do që të jetë, nuk duhet harruar se aftësia e tij për të folur në mënyrë të hapur e pa doreza nuk është frenuar kurrë nga mundësia e e të ndodhurit përpara një bashkëbiseduesi të nivelit të lartë, siç edhe e kanë demonstruar vitet e fundit e karrierës së tij ushtarake.

> **I njohur në institutet kërkimore amerikane dhe në mjediset e Mbrojtjes si "murg-luftëtar", Sekretari i Mbrojtjes lindi në fillimin e viteve '50 në një familje të lodhur me ambientet ushtarake (e ëma shërbue në inteligjencë gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa i ati punoi në industritë mbështetëse të Projektit Manhattan (atij të famshmit Projekt Manhattan). Mattis u rrit në Washington State dhe jo në shtetet e Jugut, basene tradicionale të rekrutimit të forcave të armatosura (Texas në radhë të parë)**

Kur Mattis qe Komandant i CENTCOM-it (Central Command), përgjegjës i politikës ushtarake amerikane në Lindje të Mesme, nuk pati problem që të shprehej ashpër ndaj Iranit dhe aktiviteteve destabilizuese të tij, pavarësisht se në ato vite administrata Obama po kërkonte të finalizonte një marrëveshje lidhur me çështjet bërthamore (të ashtuquajturin Nuclear Deal, sot i vënë në diskutim nga administrata Trump). Disa pëshpëritin se ky pozicionim kontribuoi që t'i përfundonte mandati një vit përpara skadimit natyral. Edhe në këto muaj një ndershmëri e tillë duket se ka mbetur e paprekur. Për të qëndruar në temën iraniane, Mattis e kështilloi Presidentin Trump që ta mbante në këmbë marrëveshjen e nënshkruar nga Obama, pavarësisht se qëndrimi i Mattis kundrejt Teheranit sigurisht që nuk ka asnjë shenjë butësie. Një tjetër mospërputhje e fortë mendimi, por sidomos fjalori, midis Presidentit dhe Gjeneralit haset lidhur me Korenë e Veriut: këtu Mattis kufizohet të flasë

për përgatitje ushtarake, duke paralajmëruar rreziqe për regjimin e Phenianit në rast aksionesh provokuese, megjithëse duke mbështetur primatin e diplomacisë, ndërsa Trump shfrytëzon çdo rast për të kërcënuar se "do ta shkatërrojë totalisht Korenë e Veriut". Një çështje tjetër potencialisht përçarëse për forcat e armatosura - si prania e subjekteve transgjinorë në radhët e tyre - është përballuar më qetësi dhe maturi, pa arritur në argumentet e ekzagjeruara të Trump. Pastaj, nëse divergjencat do të bëheshin vërtet të forta, ndoshta mund të arrihet në një situatë si ajo e përshkruar nga një artikull i Washington Examiner, sipas të cilit Tillerson, Mattis dhe Steven Mnuchin, respektivisht sekretarë të Shtetit, të Mbrojtjes dhe të Thesarit, do të ishin të gatshëm të dorëhiqeshin njëkohësisht nëse sulmet nga ana e Presidentit ndaj njërit prej tyre do të bëheshin të padurueshëm. Sikur kjo të ishte e vërtetë, padyshim që do të ishte një lëvizje e paprecedent, megjithëse vetëm largimi i Mattis do ta vinte në krizë të gjithë administratën.

PERSPEKTIVA

Përfundimisht çfarë mund të thuhet për këtë njeri? Sigurisht, mund të përdoren fjalët e tij, domethënë se "...gjatë 35 viteve të mia në Korpusin e Marinsave kam mësuar se gjëja e vetme vërtet e rëndësishme në jetë është një: të improvizosh, të improvizosh, të improvizosh". Megjithëse jeta prej politikani është padyshim ndryshe, por edhe më e komplikuar se ajo prej ushtaraku, aho që është e qartë është se Mattis posedon aftësitë për t'u përshtatur dhe të arrijë të kryejë misione që i besohen, edhe në kontekste të komplikuara. Sigurisht, reputacioni prej oficeri të shkëlqyer dhe njeriu të ndershëm që i njeh i gjithë spektri politik (dhe jo vetëm) - pavarësisht përplasjet ndryshme të kaluara me Kongresin, Komisionin e Forcave të Armatosura të Senatit dhe të Dhomës së Përfaqësuesve nuk kanë munguar - vjen në ndihmë. Michèle Flournoy, ish Nënsekretare e Mbrojtjes në administratën Obama, në një intervistë për të përjavshmen New Yorker përdori fjalët e mëposhtme për ta përkufizuar: "Jim Mattis ka më shumë integritet në gishtin e tij të vogël të dorës se pothuajse të gjithë në Uashington". Vetëm koha do ta tregojë sesi jeta e dytë e James Mattis do të zhvillohet, nëse do të arrijë jo vetëm ta kufizojë, por edhe ta drejtojë Presidentin, dhe nëse do të jetë në gjendje t'i përgatisë Shtetet e Bashkuara për sfidat aktuale dhe të ardhshme strategjike. Megjithatë, nuk duhet harruar se jeta e tij ka qenë ekskluzivisht e përkushtuar shërbimit të vendit të tij dhe se në dobësitë e pafundme e qeverisë aktuale amerikane sigurisht që ajo e tij është një prani siguruese, qetësuese. Pastaj, siç thekson një ish funksionar i Pentagonit, i cituar në të njëjtën intervistë të New Yorker, "...Mattis dëshiron të fitojë. Dëshiron fitoren. Gjenerali Mattis është luftëtar. [...] E gjithë karriera e tij është ndërtuar për të fituar". Këshillat mijëvjeçare të Mark Aurelit nuk kanë sesi të mos i jenë të dobishme.

JOE BONANNO

KUSH ISHTE MAFIOZI QË FRYMËZOI FILMIN "KUMBARI"

Bonanno (i njohur nga të gjithë si Joe Bananas), vdiq në moshën 97-vjeçare. Ai gati sa nuk qeverisi Cosa Nostra-n, por kur paqja mafioze u copëtua ai vendosi të largohej nga Nju Jorku duke emigruar në Arizona. Që nga 1981 jetonte i vetëm në një shtëpi të madhe. Kukulla dhe kujtime në çdo cep të saj. Gruaja kishte pak kohë që e kishte lënë. Si një arkivues që ishte, ruante dokumentat e jetës: "Nuk është jeta që tregojnë gazetat, apo libri i Gay Taleses 'Nderoni Atin'. As nuk i ngjan teatrit të shpikur nga Mario Puzo. Edhe filmin me Marlon Brando-n nuk kam dashur ta shoh kurrë. Jetën e kam përballuar me respektin që emri im ka, dhe krenarinë e të bërit pjesë te miqtë më të besueshëm". Prapa dritares, ndodhet shkretëtira e nxehtë. Të fshehur nën pluhur, rojat e policisë nuk kanë rreshtur kurrë së spiunuari. Bonanno thoshte duke qeshur: "Shkatërroj edhe urimet e nipit tim Joseph. Për t'i zemëruar. Ata përpiqen të kuptojnë se ndoshta nën një përqafim të pafajshëm fshihen mesazhe të koduara". Giuseppe Bonanno u largua për në Bruklin në vitin 1922, në kohën kur prefekti Mori po përgatiste fundin e 'shoqërisë së nderuar'. Giuseppe nuk ishte i pari mafioz në familjen e tij. Babi, gjyshi dhe stërgjyshi i tij ishin burra të nderit dhe të jashtëligjshëm.



20 vite më parë, ai i kënaqur ritregoi jetën e tij: "Të tjerët nuk janë më kështu që unë mund të tregoj jetën time dhe të tyren". Të tjerët qoftë miqtë, qoftë armiqtë e bënë Nju Jorkun dhe Amerikën të dridhej. Frank Costello, Vito Genovese, Albert Anastasia, John Gambino, Joe Gallo, Lucky Luciano ishin në luftë të përjetshme për fronin e "Kumbarit të kumbarëve"

I BUKUR, ELEGANT, E FLISTE PAK

Joseph Bonanno ishte i bukur, elegant, e fliste pak. Studioi në Castellammare. Ai citonte shpesh Makiavelin. "Nju Jorku i viteve 50' më dukej sikur isha ulur në një vullkan". 5 familje italo-amerikane kishin kontroll mbi çdo gjë. Këtu filloi lufta. 10 vite të përgjakshme. Në tetor të vitit 64' atij iu organizua një kurth. Ai zbriti nga një taksi në Park Avenue. Binte shi, dhe dy persona e qëllojnë pas krahëve. Bonano kupton, nuk proteston. Për 19 muaj FBI-ja, Interpoli, CIA dhe shërbimet sekrete italiane e franceze përpiqen të kuptojnë nëse është gjallë a ka vdekur. Vetëm Billi, djali i tij, merr vesh që është mirë. Mes tyre ekziston një marrëveshje. Duhet të takoheshin çdo tre të marta, në 8 të darkës, në një kabinë telefoni në Long Island. Pas një viti telefoni bie dhe një zë që Billi nuk e njeh thotë: "Do të kthehet". Kthehet më 17 maj të 1966-s në një kohë kur lufta mes klaneve kishte shkatërruar perandorinë Bonanno. Një zotëri me kapele dhe rroba të gjera të zeza, hyn në sallën 318 të Gjykatës Shtetërore të Foley Square dhe tha: "Quhem Joseph Bonanno. Mora vesh se donit të më merrnit në pyetje". E bëjnë këtë gjë për javë me rradhë. Joe-ja nuk i përgjigjet Amendamentit të Pestë. Mban të veshur të njëjtën xhaketë, të njëjtën këmishë dhe çdo gjë tjetër që mbante kur e larguan. Ku? Kur i bënë këtë pyetje, ai qeshi duke thënë: "E kujt i duhet tani?". Në moshën 97 vjeçare u largua me shumë mistere. Asnjë kapobandë nuk i ngjan deri më sot. E gjithë bota e krimit, në një farë mënyre pak romantike, vdiq bashkë me të.

Pas kontrollimit të fajdeve dhe lotarive klandestine në Bruklin, ai mori nën kontroll edhe restorantet dhe bizneset për pastrimin e parave të pista. Në 1931, u martua me Fay Labruzo, motrën e një tjetër kapoje të mafias, me të cilën pati dy djem dhe një vajzë. Atij iu dha nënshtetësia amerikane në vitin 1945

JETA

Joseph Bonanno, i lindur si Giuseppe Bonanno, dhe i ashtuquajturi Joe Bananas (18 janar 1905 - 12 maj 2002), ishte një kriminel italo-amerikan, i lidhur me Cosa Nostra-n amerikane. Ai lindi në Castellammare, një provincë e Trapanit në Itali. Babai i Bonannos, Salvatore, bënte pjesën në organizatën mafioze lokale dhe në vitin 1908 u transferua së bashku me familjen e tij, për t'i shpëtuar një dënimi, për t'u rikthyer më pas në Sicili në vitin 1911 për shkak të shpërthimit të një grindjeje në Castellammare me bandën rivale të Buccellato-s, e cila përfundon në 1913 kur Salvatore Bonanno vret kapon Felice Buccellato. Në vitin 1915 Bonanno mbetet jetim pasi i babai i tij Salvatore vdes nga një atak kardiak, dhe pas 5 vitesh humbet edhe mamanë. Gjatë kësaj kohe ai ndiqte Institutin Detar të Palermos për disa muaj. Në 1924-n Bonanno skedohet si një antifashist së bashku me kushëririn e tij Pietro Magaddino, dhe për të lënë prapa krahëve këtë proces, transferohet si klandestin së pari në Kubë e më pas në Florida, dhe në fund në Bruklin. Këtu (në Bruklin), ai arrestohet për armëmbajtje pa leje por lirohet sepse akuzat ndaj tij u tërhoqën. Ai bashkohet me disa bashkatdhetarë të udhëhequr nga mafiozi Salvatore Maranzano, i cili shkaktoi "Luftën Castellammarese" kundër Joe Masseria, kapo i Familjes Morello. Joe Bonanno bëhet zëvendës-kapo i Maranzano-ve. I dalë fitimtar nga konflikti i vitit 1931, Maranzano nominohet "Capo dei Capi" (Kapo i kapove), por vritet me urdhër të Lucky Luciano-s. Atëherë Bonanno merr komandën dhe u bë koleg me Luciano-n duke u bërë pjesë e "Komisionit" (organizata që udhëhiqte Cosa Nostra-n). Pasi mori në dorë kontrollin e Familjes, Bonanno zgjedh si zëvendës të tij kushëririn Frank Garofalo, kurse mikun dhe kolegun e tij John Tartamella si këshillues.

KONTROLLI I FAJDEVE DHE LOTARITË KLANDESTINE

Pas kontrollimit të fajdeve dhe lotarive klandestine në Bruklin, ai mori nën kontroll edhe restorantet dhe bizneset për pastrimin e parave të pista. Në 1931, u martua me Fay Labruzo, motrën e një tjetër kapoje të mafias, me të cilën pati dy djem dhe një vajzë. Atij iu dha nënshtetësia amerikane në vitin 1945. Në vitin 1952 Bonanno, zgjodhi këshilltarin e ri Carmine Galante, në Montreal të Kanadasë, për organizi-

min e trafikut të drogës, në bashkëpunim me kalabrezin Vic Cotroni. Në vitin 1956, fëmija i parë i Bonanno-s, Salvatore, martohet me Rosalie Profacin, mbesën e Joe Profaci-t, kapo i Familjes, gjë që çoi në përforcimin e aleancës midis dy Familjeve. Në vitin 1957, Bonanno realizoi një udhëtim në Siçili, i shoqëruar nga Carmine Gelante, dhe nga data 12-16 tetor, mori pjesë në disa takime që u mbajtën në Grand Hotel des Palmes në Palermo, me John Bonventre-n dhe Frank Garofalo-n, eksponentë të Familjes së tij, dhe mafiozë të tjerë amerikanë (Lucky Luciano, Santo Sorge, Vito Vitale dhe John di Bella, eksponentë të Familjes Genovese në Nju Jork). Në takim kishte dhe sicilianë të tjerë si Gaspare Magaddino, Cesare Manzella dhe Giuseppe Genco Russo. Hetuesit dyshonin se takimi i tyre kishte të bënte me trafikimin e drogës. Operacioni policor që u bë në Kubë në vitin 1956-1957 ndaloi mafiozët siçilianë dhe amerikanë në përpunimin e heroinës. Sipas bashkëpunuesit të drejtësisë Tomasso Buscetta, gjatë takimeve të Bonanno-s diskutohej për krijimin e "Komisionit" të mafiozëve sicilianë e amerikanë, ku dhe duhej të vihej rregull. Pak kohë më pas, Bonanno mori pjesë në një mbledhje në Nju Jork, së bashku me të gjithë Familjet mafioze të Amerikës, por takimi u zbulua nga policia lokale, që arrestoi shumë pjesëmarrës, përfshi dhe Bonannon, por që më pas u lirua për mungesë provash. Pas vdekjes së Joe Profaci-t në 1962-shin, zëvendës-kapo Joseph Magliocco merr komandën e Familjes së tij dhe u prezantua tek Bonanno si pasardhësi i tij. Bonanno dhe Magliocco, konsideronin të rrezikshëm për ta, Carlo Gambino-n dhe Gaetano "Tommy" Lucchese-n, pjesë të familjeve të tjera mafioze, sepse ata ishin bashkëpunëtorë më disa armiq të Magliocco-s.

Joseph Bonanno, i lindur si Giuseppe Bonanno, dhe i ashtuquajturi Joe Bananas (18 janar 1905 - 12 maj 2002), ishte një kriminel italo-amerikan, i lidhur me Cosa Nostra-n amerikane. Ai lindi në Castellammare, një provincë e Trapanit në Itali

RIKTHIMI I KAPOS SË VJETËR

Ata vunë mafiozin Joseph Colombo për t'i vrarë. Colombo preferoi t'i informonte Gambinon dhe Luchessen duke bërë që Bonanno dhe Magliocco të dilnin para "Komisionit". Bonanno nuk u prezantua kurse Magliocco u detyrua t'ia linte të gjithë pushtetin e familjes së tij Joseph Colombo-s. Bonanno pas kësaj, sajoi një ngjarje, duke i bërë të tjerët të besonin se e kishin vrarë. Kurse në realitet ishte larguar nga Shtetet e Bashkuara dhe kishte shkuar refugjat në Tunizi. Në të njëjtën kohë Gaspar di Gregorio merr kontrollin e familjes së Bonannos, i mbështetur nga Gambino, Luchesse dhe të tjerë anëtarë të "Komisionit". Por aty u përball me djalin e parë të Bonanno-s, Salvatore, i cili kërkonte rikthimin e kapos së vjetër. Në vitin 1966, Bonanno iu dorëzua autoriteteve, dhe pas një ataku në zemër në vitin 1968 preferoi të tërhiqej nga jeta e tij mafioze bashkë me djalin e tij, Salvatore, në shtëpinë e tij në Arizona. Në vitin 1980, Bonanno u arrestua për pengim të drejtësisë, dhe u dënua me 5 vjet burg, por bëri vetë 8 muaj për shkak të problemeve me shëndetin. Në vitin 1983 ai u përpoq të rindërtonte imazhin e tij duke publikuar autobiografinë "Një burrë nderi", e shkruar nga një bashkëpunëtor i tij. Kjo gjë shtyu gjykatën ta merrte në pyetje për disa fakte të shkruara në libër. Bonanno refuzoi të paraqitej, dhe u dënua me 14 muaj burg. Ai vdiq në shtëpinë e tij më 12 maj 2002, në moshën 97-vjeçare. *(Tirana Observer)*

ME MOTOR SHARRË DERI TE PESHQIT

Liqeni i pasur Hamurpet i mbuluar me akull dhe peshq është njëlloj akuariumi natyror, ndërsa peshkatarët në minus 20 gradë celsius me motor sharrë çajnë akullin për të kapur peshq

Liqeni Hamurpet në lindje të Turqisë gjendet në një lartësi mbidetare prej 2.150 metrash dhe disa muaj gjatë vitit është i mbuluar me një shtresë të trashë të akullit, por kjo nuk u pengon peshkatarëve lokalë, të cilët për çdo ditë shkojnë të kapin peshq. Liqeni gjendet në malin e rajonit Varto në provincën Mus, ndërsa peshkatarët e atjeshëm janë të njohur për peshkimin në të cilin me motor sharra është pjesa përbërëse e pajisjes themelore të peshkimit. Liqeni i pasur Hamurpet i mbuluar me akull dhe peshq është njëlloj akuariumi natyror, ndërsa peshkatarët në minus 20 gradë celsiusë me motor sharrë çajnë akullin dhe për disa orë çdo ditë kapin deri në gjysëm ton karp dhe lloje të tjera të peshkut. Ferhat Basaran për Anadolu Agency tha se në orët e hershme të mëngjesit me kolegët peshkatarë vendosin rrjetën në buzë të akullit, ndërsa ditën e nesërme vijnë e nxjerrin gjahun. "Këto nuk janë kushte të lehta për peshkim, por njeriu doemos duhet të përballet me rrethanat për të fituar për kafshatën e gojës. Ky vend parajsor ofron shumë, ndërsa njeriut duhet t'ia dalë. Ja ne jemi gjetur dhe po na shkon shumë mirë", tha Basaran. Ndërkohë edhe peshkatari Firat Subashi tha se fitimi i bukës së ngrohtë në liqe të ngrirë nuk është lojë fëmijësh, por biznes serioz, që kërkon shumë mund por edhe dashuri ndaj punës.

KUJDES, GËNJESHTRAT TË SËMURIN

Shfajësime, hipokrizi për interes, justifikime pa vend: të gjithë e bëjnë këtë për t'iu shmangur konvikteve. Por duhet pasur kujdes, sepse gënjeshtrat mund të të sëmurin dhe ato janë vrastare për lidhjet mes njerëzve

Jam shumë mirë, më mirë s'bëhet! Kjo është gënjeshtra më e shpeshtë, që njerëzit i thonë njeritjetrit. Po ashtu ata justifikohen në rast të ndryshme me argumente false ("Nuk kisha rrjet për të folur me celular", "u bllokova në trafik") apo konstatime false si "je bërë elegante" bëjnë pjesë ndër dhjetë gënjeshtrat e së përditshmes, sikurse liston një sondazh i Muzeut të Shkencës në Londër (Science Museum of London). Një ankesë prestigjioz i institutit të hulumtimeve të tregut "Splendid Research" rezulton, se 60 për qind e gjermanëve gënjejnë çdo ditë. Por gënjeshtra nuk është vetëm gjermane, ajo është një dukuri globale. Studimet arrijnë në konkluzione, se shumica e njerëzve gjatë një bisede dhjetëminutëshe të paktën një herë thonë të pavërteta. Nëse këto shifra janë të sakta, është e vështirë të verifikohet. Sidoqoftë studiuesit në sondazhet e tyre janë të varur nga ajo që thonë të intervistuarit, nëse ata thonë të vërtetën ose gënjejnë.

TA KTHEJ ME TË NJËJTËN MONEDHË

"Unë gënjej, në mënyrë që nëna ime të jetë e kënaqur", shkruan një përdorues në Facebook duke iu përgjigjur pyetësoit të Deutsche Welle-se se cilat janë arsyet për të mos thënë të vërtetën. 49 për qind e të pyeturve thonë, se nuk tregojnë të vërtetën për të inkurajuar dikë apo për t'i bërë atij qejfin. "Bashkëjetesa funksionon mirë vetëm atëherë kur nuk cenon vetëdijen e tjetrit", thotë sociaopsikologu në Universitetin e Kaselit Marc-André Reinhard. Ndaj një shoqëri pa gënjeshtra është e paimagjinueshme. "Ne jemi shumë të ndjeshëm, kur është fjala për informacione negative lidhur me personin tonë, që dëmtojnë imazhin që kemi ne për veten." E meqenëse shpesh e vërteta është e dhimbshme, ne kapemi pas gënjeshtrave të vogla. Për këtë arsye ne preferojmë më mirë ta lëvdojmë krehjen e flokëve të një shoqeje, se sa t'i themi asaj sa keq që dukesh. E po ashtu edhe shoqja nuk ta kthen p.sh "ua sa qenke trashur". Pra nëse ti respekton vetëdijen time, edhe unë respektoj atë tënden.

MË PAK GËNJESHTRA MË PAK DHIMBJE KOKE DHE DEPRESIONE

E pra të themi tani na rroftë gënjeshtra? Jo, kaq e thjeshtë nuk është. Sepse shumë gënjeshtra që ne themi për t'i bërë qejfin dikujt e për të mbrojtur veten një ditë mund të na dëmtojnë shëndetin dhe psikik dhe atë fizik. Në varësi nga përmasat e gënjeshtrës mund të bëhet e vështirë që vazhdimisht të të duhet të fshehësh diçka. Një studim i American Psychology Association nën drejtimin e psikologes Anita Kelly mundi të tregojë, se më pak gënjeshtra bëjnë të jesh më i shëndetshëm. Të të duhet vazhdimisht të fshehësh diçka kjo mund të shkaktojë dhimbje koke, gjendje ankthi dhe depresione. Studiuesit kanë hulumtuar efektin e gënjeshtrës tek një grup njerëzish duke u kërkuar atyre të shmangin të ashtuquajturat "white lies" - gënjeshtrat e së përditshmes. Studiuesit hulumtuan dy javë resht gjendjen shpirtërore dhe fizike të personave me pakësimin e gënjeshtrave. Pas dhjetë javësh ata raportuan se iu zhduk dhimbja e kokës dhe të tjera simptoma shqetësuese. Po ashtu gjatë kësaj periudhe edhe marrëdhëniet ndërnjerëzore u përmirësuan. Një gënjeshtër e vogël mund të shmang në fakt konfliktin për momentin, por ajo edhe të distancon pikërisht nga personi me të cilin do të jesh afër. Ne kemi nevojë për gënjeshtrën, për të mos hyrë në konflikt, por nga ana tjetër përmasat e gënjeshtrës dëmtojnë shëndetin tonë. Atëherë si t'ia bëjmë? Të themi gjithmonë të vërtetën sado e hidhur qoftë?

Psykologia Kelly propozon: më pak ka më shumë vlerë: Sa më pak ekzagjerime, sa më pak justifikime. Në vend të kësaj ndoshta mjafton një "më vjen keq". Po ashtu mund të ndihmojë edhe që t'ia ndalosh vetes gënjeshtrën, shkruajnë studiuesit. Kush e bën këtë shmang edhe bërjen e gjërave, pas të cilave pastaj do të të duhet të gënjesh. *(DW)*

MË THUAJ NË ÇFARË ORE TË DEL GJUMI, TË TË THEM ÇFARË PROBLEMI PO KALON

Sipas mjekësisë tradicionale kineze, çdo orë e ditës dhe e mbrëmjes përkon me një fluks energjie që ndikon në shëndetin fizik dhe mendor të njeriut. Por, ndryshe nga ç'mund të perceptohet janë organet ato të cilat kontrollojnë këtë fluks energjie, por edhe e ndjejnë mungesën e saj në orët e pagjumësisë. Zbuloni çfarë tregon për gjendjen tuaj psiko-fizike zgjimi në orare të caktuara:



- Nëse jeni nga ata njerëz që pëlqejnë të shkojnë në shtrat herët, por ju del gjumi nga ora 21 deri në 23 të mbrëmjes, me siguri po kaloni një periudhë të vështirë dhe keni nevojë të qetësoheni. Sipas mjekësisë kineze, energjia e këtij intervali kohor është e përqendruar tek perikardi, membrana që mbulon zemrën dhe është përgjegjëse për qarkullimin e gjakut.

- Nëse zgjoheni nga ora 23 e mbrëmjes deri në orën 1 të natës, mund të keni vështirësi në marrjen e vendimeve dhe trupi ashtu si psikika e vuan këtë gjendje konfuzioni. Në këto orë energjia e trupit është e përqendruar tek fshikëza e tëmthit, e cila përkon me guximin.

- Nëse keni probleme me gjumin dhe zgjoheni vazhdimisht mes orëve 1 dhe 3 e mëngjesit, bëni mirë t'i lini në shtrat zemërimet dhe mëritë e ditës. Energjia e këtyre orëve korrespondon me mëlçinë, organ i lidhur ngushtë me kontrollin e nervozizmit, zemërimit dhe mërisë.

- Është ora 3 e mëngjesit dhe ju i keni sytë tavan?! Ora shënon 4.30 dhe asnjë përmirësim? Mos u shqetësoni, ky është një "problem" që ndajnë të gjithë njerëzit inteligjentë. Fasha orare 3-5 e mëngjesit përkon me rizgjimin e energjisë së intelektit. Sipas mjekësisë kineze, e gjithë kjo energji është e përqendruar tek mushkëritë, një organ i lidhur me trurin dhe mirëqenien dhe që sjell energji primare në të gjithë organizmin.

DASHI 21. mars - 20. prill

Marrëdhënia në çift do jetë e mrekullueshme gjatë kësaj dite. Nuk do debatoni për asgjë me partnerin/en, përkundrazi do zgjidhni gjithçka me maturi dhe qetësi. Beqarët mund të kenë njohje të reja, por nga ato mund të fillojnë vetëm histori dashurie të shkurtra. Të ardhurat fatmirësisht nuk do kenë probleme.

DEMI 21. prill - 21. maj

Ditë e paqëndrueshme dhe e mbushur me debate të njëpasnjëshme për jetën tuaj në çift. Kujdes me gjithçka që do thoni sepse mund ta lëndoni thellë partnerin/en. Beqarët do kenë takime dhe propozime, por vetëm kaq sot. Ditë e turbullt për financat. Mirë do ishte të shmangnit çdo lloj investimi apo transaksioni.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Ambient shumë i ngrohtë në jetën tuaj në çift. Do ndiheni më afër se kurrë me partnerin/en dhe do flisni me të edhe mbi tema të cilat më parë kishit turp. Beqarët më mirë të qëndrojnë vetëm edhe sot që të mos kenë zhgënjime dhe të mos lëndohen. Financat do jenë në të njëjtën gjendje si disa kohë më parë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Dialogu në çift do ekzistojë gjatë gjithë kësaj ditë dhe do e keni të lehtë të merreni vesh me njeri-tjetrin. Edhe momentet romantike do jenë të shumta. Beqarët me shumë gjasë do i rikthehen një dashurie të vjetër, por që për ta ka pasur rëndësi të madhe. Në planin financiar duhet të shmangni operacionet e mëdha.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Falë mbështetjes që do iu japin yjet marrëdhënia në çift do shkojë më së miri sot. Personi që keni në krah do ju bëjë të ndiheni si mbi re. Edhe beqarët do e gjejnë personin e duhur me të cilin do ja vlejë të krijojnë një lidhje. Financat edhe mund të jenë të trazuara për shkak se do ju duhet të kryeni disa shpenzime të nevojshme.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ka shumë mundësi që jeta juaj në çift të marrë një tjetër drejtim sot. Do i shprehni më tepër ato që ndjeni dhe do bashkëpunoni për gjithçka me atë që keni në krah. Beqarët do kenë gjëra të tjera për të menduar dhe nuk do e mbajnë mendjen tek krijimi i një lidhjeje. Të ardhurat do përmirësohen dalëngadalë.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Ambient i zymtë sot në jetën tuaj në çift. Mezi do prisni që dita të mbarojë duke shpresuar se të nesërmen gjithçka do ndryshojë. Beqarët do bëjnë mirë të mos ju besojnë të gjithë atyre që do i joshin. Perspektivat financiare janë të mira kështu që mund të kryeni edhe ndonjë investim.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Asnjë planet nuk do prekë drejtpërdrejt sektorin e dashurisë së çifteve sot, megjithatë marrëdhënia në çift do ketë probleme. Kujdes me kokëfortësinë. Beqarët duhet të tregohen edhe më të hapur nëse duan të gjejnë një person për të krijuar lidhje. Në planin financiar mos ndërmerrni rreziqe.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ditë e mrekullueshme kjo e sotmja për të dashuruarit. Do i harroni të gjitha mosmarrëveshjet që keni pasur dikur dhe do mendoni vetëm për të ardhmen. Beqarët nuk do e kërkojnë me ngulm dashurinë sepse edhe ashtu si janë ndihen mirë. Në planin financiar shpenzoni sa ua mban xhepi.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Ndikimi i yjeve do jetë shumë i madh sot në jetën tuaj në çift. Do kuptoheni më së miri me njeri-tjetrin dhe askush nuk do ua prishë harmoninë. Beqarët do takojnë persona interesantë nëpër festat ku do shkojnë. Në planin financiar duhet të tregoheni të matur edhe pse situata nuk do ketë probleme.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Do largoheni paksa nga partneri/ja juaj sot dhe nuk do përjetoni ato emocione që keni dëshiruar. Dita nuk do jetë aspak e mirë dhe do mërziteni. Beqarëve do ju plotësohen dëshirat dhe do e gjejnë princin e tyre të kaltër. Në planin financiar duhet të tregoheni më të kujdesshëm.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do keni më shumë nevojë për qëndrueshmëri në jetën tuaj në çift sot. Mirë do jetë të flisni hapur me partnerin/en dhe të dy së bashku të merrni vendimet e duhura. Beqarët do tërhiqen mjaft nga persona më të mëdhenj se ata. Në planin financiar duhet të merrni disa masa për të stabilizuar situatën.

Mensur Mamuti	REGJISORI YNË, KOCI	NDREQJE E FOTOGRAFISË ME VEGLA TËPOSAÇME	KËNGËTARJA SKOCEZE NË FOTO	PARTNERI MUZIKOR I KËNGËTARES NË FOTO (SHQ.)						
PERËNDIA GREKE E LUFTËS										
LLOJ CIGARESH										
PËREMËR PRONOR										
OPERË E ALBAN BERGUT										
KOHA	FUTBOLLISTI ANGLEZ, XHEJMS (ORIGJ.) / DRY (SH.)									
KALIUMI		NUMËR / SOLO ALBUM I KËNGËTARES NË FOTO								
POZICION NË FUTBOLL (SH.)										
HIT I KËNGËTARES (DUETIT) NË FOTO "SËRISH ..." (HERE COMES THE RAIN AGAIN)	V	BEKOJ, I JAP URATËN	TULUZ LOTREK	ITALIA	TECHNICAL KNOCK OUT	VRAPUESI MAROKAN, MOHAMED / MELIHATE AJETI				
DUETI I KËNGËTARES NË FOTO ME D.S. / NJË ANË E BOTËS										HIT I KËNGËTARES (DUETIT) NË FOTO "ËNDRRAT ..." (SWEET DREAMS)
V				VARKË INDIANE / BOKS, KATROR					Ë / TË HEQURIT BARK, TË DALËT JASHTË SHUMË	
PARASHTESË PËR FJALËT LIDHUR ME NARKOMANINË						KOMPOZITORI ARMEN, HAÇATURIJAN / KILOVAT AMPER				
FUTI, HODHI LËNG NË NJË ENË					LARVË / AKTORJA AMERIKANE, MARGARET					
HËNË E JUPITERIT / KONAKU, FJETORJA			BUDALLA (BISED.) / TEMPERATURA							
B								NOTË MUZIKORE		

ZGJIDHJET: ARES, KENT, I TIJ, LULU, SHEA, , KNR, ALOT, V, TAKI, JURITMIKS, VERI, KANU, Ë, NARKO, ARAM, SHTIU, KRIMB, IO, TEVEQEL, BUJTINAT, LA.

Sudoku

shumë i lehtë

				9		6	3	
2	3		1				4	
					4		2	
6			2					4
		1		7		2		
					1			
	4		9					
	9				8		7	
	7	5		6			1	

mesatar

	2		3	5		8	9	
		3			9		2	5
8						7		
	8		9					1
9								3
3					4		8	
		6					5	
4	3		7					2
	9	7		6	2	3		

Shumë i lehtë: 514792638, 238156749, 769384521, 687235194, 451879263, 923641857, 146927385, 392518476, 875463912. **Mesatar:** 124357896, 673849125, 859216734, 785923461, 942681573, 361574289, 216438957, 438795612, 597162348.

DUHANPIRËSIT JANË ME PAK JOSHËS

Edhe pse shumë persona mendojnë se kur pinë duhan duken më joshës në fakt një studim ka treguar të kundërtën. Është dëshmuar shkencërisht se njerëzve u duken duhanpirësit më pak tërheqës sesa ata që nuk pinë duhan. Studimi i kryer nga hulumtues të Universitetit të Bristolit, kishte përfshirë 500 pjesëmarrës të cilëve u ishin prezantuar fytyra me binjakë identikë. Dy qëllimet kryesore të këtij hulumtimi kishin qenë të zbulonin se a është e mundur të kuptohet vetëm duke e shikuar dikë në fytyrë se a pinë duhan, dhe se a ndikon duhanpirja në atë se sa joshës është një person. Ka shumë faktorë të cilët ndikojnë në pamjen fizike të një personi, duke përfshirë moshën, gjininë dhe ambientin. Prandaj, në mënyrë që të arrihen rezultate sa më të sakta, hulumtuesit kanë eksperimentuar vetëm me binjakë identikë, të cilët kishin pasur të njëjtin material gjenetik dhe shumë aspekte të njëjta. Rezultatet kishin qenë mjaft mbresëlënëse, ku pjesëmarrësit 70 për qind të kohës ia kishin qëlluar se cili person kishte qenë duhanpirës, ndërsa edhe meshkujt edhe femrat i kishin zgjedhur personat të cilët nuk kishin qenë konsumues të duhanit si më joshës. Hulumtuesit besojnë se këto zbulime mund të shërbejnë si instrument për promovimin e lënies së duhanit, e në veçanti te të rinjtë.

DISNEY PREZANTON ROBOTIN TRUMP

Donald Tramp ka tashmë edhe versionin e tij robot në sallën e presidentëve - jo të Shtëpisë së Bardhë - por të parkut të famshëm të lojërave Disney në Florida. Trampi robot bëri prezantimin në sallë gjatë shfaqjes, ku të pranishëm ishin qindra të pasionuar pas botës së animacionit. Versioni robot i presidentit të 47-të të Shteteve të Bashkuara mbajti edhe fjalën përshëndetëse shoqëruar edhe me gjeste. Zëri i robotit është origjinal. Vetë presidenti Tramp regjistroi posaçërisht zërin e tij në bashkëpunim me shtëpinë e filmave të animuar Disney. Parashikohej që roboti të prezantohej brenda 4 korrikut, festës kombëtare të Shteteve të Bashkuara, por u shty për shkak të agjendës së Presidentit. Robotët presidencialë kanë zërin origjinal të presidentëve prej 1990-ës. Kritika në rrjetet sociale për fytyrën e robotit, të cilin në shumë raste e krahasojnë me aktorin John Void, madje edhe si një përzierje mes Trump dhe Hillary Clinton.

PËRMES ROBOTËVE, GOOGLE DO T'I RIKTHEJË TË VDEKURIT NË JETË

Një raport i ri i publikuar nga TechWeek thotë se Google mund të fillojë të punojë mbi disa mënyra që do t'i japin robotëve një personalitet të përshtatur, që ngjan me njerëzit e vërtetë apo ata të vdekur. Kompanisë i është dhënë një patentë nga autoritetet amerikane, e cila flet për metodat dhe sistemet për zhvillimin e personalitetit të robotëve. Ideja është që një robot potencialisht mund të përshtatet, ose të programohet që të ketë karakteristika të personalitetit të përshtatur, si dhe aftësi të lidhura nga platforma kompjuterike të cilën e njohim si cloud, raporton Telegraf. Në dokumentin e patentës deklarohet: "Një robot mund të programohet që të japë një vështrim të dëshiruar si dhe të ketë kokëfortësi të robotit, e cila mund të ndryshohet nga ana e përdoruesit ose nga vetë roboti. Për shembull, ndërfaqja e robotit të përshtatet për të dhënë një personalitet për robotin". "Personaliteti i robotit mund të shpaloset më tej dhe të jetë i shpërndarë tek një numër më i madh i robotëve në vende të ndryshme". Një anë potencialisht e errët e patentës është se Google do të mund ngarkojë personalitetet e njerëzve të vërtetë, duke përfshirë edhe të vdekurit. Patenta e Google më tej thotë se "robotët mund të programohen për të marrë tipare nga personaliteti i njerëzve të vërtetë (p.sh., të sillen në bazë të dëshirës së përdoruesit, apo të një të të afërmi të vdekur, një njeriu të famshëm dhe kështu me radhë), në mënyrë që të marrë tipare të karakterit të njerëzve që më pas do të ndiqen nga roboti".

KALENDARI HISTORIK 25 DHJETOR

1 - Kërshëndella e parë, sipas themeluesit të kalendarit Dionisus Eksiguus

800 - Papa Leo III kurorëzon Karlin e Madh (Sharleman) Perandor romak.

1066 - Uiliam Pushtuesi kurorëzohet mbret i Anglisë.

1492 - Anija e Kolombos "Santa Maria" ndalet në limanin e Republikës Domenikane.

1522 - Trupat turke okupojnë Rodosin.

1745 - Prusia dhe Austria nënshkruajnë Traktatin e Drezdenit ku një pjesë e madhe e Silesisë i jepet Prusisë.

1926 - Hirohito shpallet Perandor i Japonisë.

1936 - Peshkopët belg dënojnë fashizmin dhe komunizmin.

1942 - Beteja e artilerisë dhe tankeve ruse kundër ushtrisë gjermane në Stalingrad.

1964 - E dashura e George Harrison, Patti Boyd sulmohet nga grupi in femrave fansa të Beatles.

1979 - Aeroplanët ushtarak rus sulmojnë Afganistanin.

A E DINI SE...

28.638.131 dollarë ishin të ardhurat e filmit në Shtetet e Bashkuara gjatë fundjavës së parë të filmit (19-21 Dhjetor 1997). Titaniku ka qenë në sallat e botës 287 ditë (në Itali duke filluar nga 16 janari 1998)



Distanca e udhëtuar nga Titaniku në mes të 10 prillit 1912 (largimi nga Southampton) dhe përplasja me ajsbergun në natën ndërmjet 14 dhe 15 prillit 1912 është e barabartë me 2.070 milje.



BARSOLETA

DJALI I VOGËL

Një djalë i vogël pyet të ëmën:
- Mami, kush ma ka dhënë inteligjencën mua? Ti apo babi??
- Me siguri yt atë, sepse unë e kam akoma timen...

THËNIA E DITËS

Pushteti është aty ku njerëzit besojnë se është. Është një hile, një hije në mur. Dhe një njeri shumë i vogël, mund të lëshojë një hije shumë të gjatë. **(Lord Varys)**